



RAPORTI I PUNËS I SINDIKATËS TË POLICISË SË KOSOVËS

2022-2025

Z. Avdi HOTI
Nënkryetar i SPK
Maj, 2025



SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS

SINDIKAT POLICIJE KOSOVA

KOSOVO POLICE UNION

Nr. Fiskal: 600595899

Rruga "Luan Haradinaj" Prishtinë



RAPORTI I PUNËS I SINDIKATËS TË POLICISË SË KOSOVËS

2022-2025

Z. Avdi HOTI

Nënkryetar i SPK

Maj, 2025

HYRJE

RAPORTI I PUNËS – MANDATI I SINDIKATËS SË POLICISË SË KOSOVËS (2022–2025)

Zëri që nuk është ndalur asnjëherë në mbrojtje të dinjitetit policor

Ky raport përmbledh të arriturat, sfidat dhe përkushtimin e palëkundur të Sindikatës së Policisë së Kosovës gjatë mandatit të saj trevjeçar (2022–2025), një periudhë e karakterizuar nga angazhim i jashtëzakonshëm, vendosmëri institucionale dhe bashkëpunim i frytshëm me akterët vendimmarrës. Gjatë këtij mandati, Sindikata ka qenë zëri i qartë dhe i pandalshëm i zyrtarëve policorë në përpjekjet për përmirësimin e kushteve të punës, avancimin e të drejtave profesionale, ekonomike dhe ligjore, si dhe mbrojtjen e integritetit dhe mirëqenies së secilit pjesëtar të Policisë së Kosovës.

Me vizion të qartë dhe qëndrueshmëri në veprim, Sindikata ka luajtur një rol kyç në proceset më të rëndësishme ligjore dhe administrative që kanë prekur drejtpërdrejt jetën dhe dinjitetin e zyrtarëve policorë – përfshirë miratimin e Ligjit për Pagat, shtesat për rrezikshmëri, çështjen e sigurimit shëndetësor dhe rikthimin e benefiteve të mohuara. Çdo sukses i arritur është rezultat i një pune të pandërprerë, konsultimeve të shumta me anëtarësinë dhe përfaqësimeve të denja në institucionet shtetërore dhe publike.

Ky raport nuk është vetëm një përmbledhje statistikore – por një dëshmi e fuqisë së organizimit sindikal, një dokument që tregon se kur zëri i policëve është i bashkuar, ai mund të dëgjohet fuqishëm dhe të ndryshojë realitetin.

LIGJI I PAGAVE DHE SHITESAT NË PAGË – NJË FITORE E ZËRIT SINDIKAL

Sindikata e Policisë së Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë dhe konstruktiv me menaxhmentin policor, ka punuar fuqishëm në procesin e hartimit, përmirësimit dhe avancimit të Ligjit për Pagat dhe sistemit të shtesave në pagë për zyrtarët policorë. Që nga themelimi i saj, Sindikata ka mbajtur një bashkëpunim të vazhdueshëm me Qeverinë e Kosovës, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Financave, Komisionin Parlamentar për Siguri dhe institucionet e tjera relevante, duke u bërë kështu një zë i fuqishëm dhe i pandalshëm në mbrojtje të të drejtave ekonomike dhe profesionale të zyrtarëve policorë.

Në çdo fazë të procesit legjislativ dhe ekzekutiv, Kryesia Ekzekutive e Sindikatës ka paraqitur me profesionalizëm kërkesat e bazuara dhe argumentet e domosdoshme, duke ndikuar realisht në përmbajtjen dhe strukturën e ligjit. Pikërisht përmes këtij angazhimi të pandërprerë dhe serioz, është arritur që koeficienti për zyrtarët policorë të rritet dhe të jetë në përputhje me standardet profesionale, nivelin e rrezikshmërisë dhe përgjegjësinë e lartë që mbajnë çdo ditë në detyrë

Koeficientët fillimisht ishin të ulët, sidomos për pozitat Polici i Ri, Polici dhe Polici i Lartë, por përmes angazhimit të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm në media, si dhe kontakteve me menaxhmentin dhe institucionet qeveritare, kemi arritur që koeficientët të rriten ndjeshëm për këto pozita. Fillimisht, koeficientët ishin:

- Kadeti (2),
- Polici i Ri (4),
- Polici (4.2),
- Polici i Lartë (4.3),
- Rreshteri (4.8),
- Togeri (6.4),
- Kapiteni (7),
- Majori (8),
- Nënkoloneli (8.5),
- Koloneli (9.8),
- Drejtorët në Departamentet e Policisë (11),
- Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm (12.6) dhe
- Drejtori i Përgjithshëm (14).

Sa i përket këtyre koeficientëve, Sindikata e Policisë së Kosovës nuk është pajtuar me këtë nivel koeficientësh dhe i ka dërguar komentet e veta dy here rradhazi dhe fale angazhimit të Sindikatës në Komisionin Qeveritar është arritur që koeficienti të ngritet si ne vijim:

- Kadeti (2)
- Polici i Ri (4.5)
- Polici (5)
- Polici i Lartë (5.9)

- Rreshteri (6.4)
- Togeri (7)
- Kapiteni (7.4)
- Majori (8.2)
- Nënkoloneli (9.2)
- Koloneli (10.2)
- Drejtorët në Departamentet e Policisë (11.2)
- Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm (12.8)
- Drejtori i Përgjithshëm (14.5)

Me plot të drejtë mund të thuhet se kjo është një arritje e madhe e Sindikatës së Policisë së Kosovës, sidomos për pozitën nga Polici i Ri deri te gradën e Togerit.

Në vazhdimësi, Sindikata e Policisë së Kosovës ka qenë e angazhuar me përkushtim të madh në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të stafit civil të Policisë. Përmes një angazhimi të pandërprerë dhe përfaqësimit të fuqishëm, është arritur të realizohen përmirësime konkrete dhe të domosdoshme në trajtimin e tyre. Rezultatet e arritura në këtë drejtim janë dëshmi e qartë e punës së palodhshme dhe përkushtimit të Sindikatës së PK-së për të siguruar kushte më të mira dhe trajtim të dinjitetshëm për të gjithë punonjësit.

Në kuadër të Propozimit V, është bërë kategorizimi i pozitave profesionale dhe teknike-mbështetëse në Policinë e Kosovës, duke vlerësuar specifikat dhe rëndësinë e tyre të veçantë. Këto pozita nuk mund të krahasohen me institucionet e tjera publike, për shkak të natyrës unike të punës.

Falë këtij ndryshimi, stafi civil tashmë njihet zyrtarisht si pjesë integrale e Policisë së Kosovës. Projektligji – nëpunësit e shërbimit civil, nëpunësi i shërbimit publik dhe nëpunësi teknik dhe mbështetës

Në kuadër të kësaj kategorie përfshihen pozitat Profesional 1, Profesional 2 dhe Profesional 3, për shkak të specifikave të natyrës së punës së stafit. Në stafin e Policisë, këto pozita paraqesin veçori dhe dallime të rëndësishme në raport me institucionet tjera. Në këtë kontekst, është vlerësuar se këto pozita duhet të trajtohen në mënyrë të veçantë, pasi kompleksiteti i detyrave dhe përgjegjësi që kanë në Polici është dukshëm më i lartë në krahasim me shumë institucione të tjera.

Gjithashtu, në kuadër të stafit të kategorisë "Nëpunës teknik dhe mbështetës 3", ku përfshihet një numër i konsiderueshëm i personelit të Policisë së Kosovës, bëjnë pjesë edhe pozita të cilat janë tërësisht unike për Policinë dhe nuk kanë krahasim me pozita të ngjashme në institucionet tjera publike. Këto janë pozitat si: Mekanik i Armëve; Autoelektricitist; Autolarës; Automekanik; Elektricitist; Mekanik i Makinërisë për Gjenerator; Teknik i Ngrohjes Qendrore; Teknik i Elektrikës për Gjenerator; Teknik i Ndërtimit; Teknik i Zdrukthtarisë; Ujinstalues; Zdrukthtar.

Për këto pozita, koeficienti është nivelizuar fal angazhimit tone si Sindikate.

Është shumë me rëndësi të theksohet se të gjitha këto të arritura dhe modifikime janë rezultat i angazhimit të vazhdueshëm dhe të palodhshëm të Sindikatës së Policisë së Kosovës, e cila në mënyrë të pandërprerë ka qenë në mbrojtje dhe përfaqësim të interesave edhe të stafit civil të

Policisë, duke arritur që përmes përkushtimit dhe përfaqësimit të fuqishëm të realizojë këto përmirësime të rëndësishme.

"Zëri ynë – Forca jonë! Për një polici të respektuar dhe të shpërblyer me dinjitet."

ANGAZHIM KONKRET PËR MIRËQENIEN E ZYRTARËVE POLICORË – SHITESAT E RREZIKSHMËRISË, NJË ARRITJE PËR POLICINË E KOSOVËS

Në kuadër të përkushtimit të palëkundur për përmirësimin e kushteve të punës dhe avancimin e të drejtave të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, Sindikata – përmes Këshillit Drejtues – ka mbajtur takime të rregullta me anëtarët, ka analizuar shqetësimet reale të tyre dhe i ka adresuar ato në institucionet më të larta shtetërore. Këto diskutime të strukturuar kanë rezultuar me një ndër arritjet më domethënëse të këtij mandati: miratimin dhe ndarjen zyrtare të shtesave të rrezikshmërisë për zyrtarët policorë nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues qeveritarë, sindikata ka theksuar urgjencën për rishikimin e pagave, përmirësimin e kushteve të punës dhe ekzekutimin e të drejtave ligjore të zyrtarëve, përfshirë zbatimin e aktgjyqimeve të rëndësishme që kanë për synim sigurinë, dinjitetin dhe mirëqenien e pjesëtarëve të Policisë – qoftë në uniformë apo staf civil.

Rezultati konkret është një vendim qeveritar që klasifikon shtesat e rrezikshmërisë në shtatë kategori, sipas nivelit të rrezikut dhe përgjegjësive në detyrë konkretisht:

- Njësia Speciale Intervenuese, Njësia për Ndërhyrje të Shpejtë, dhe Njësia për Mbrojtje të Afërt do të përfitojnë 150 euro shtesë mbi pagën bazë.
- Njësia për Eksplozivë dhe Deminim do të kompensohet me 120 euro shtesë në muaj.
- Patrullat kufitare do të marrin 100 euro në muaj, ndërsa pjesëtarët e hetuesisë do të kompensohen me 75 euro.
- Ekipet reaguese dhe patrullat e rregullta, që përfaqësojnë numrin më të madh të zyrtarëve policorë në terren, do të marrin 60 euro shtesë.
- Policët që angazhohen në sigurinë e objekteve dhe ata në menaxhimin e operacioneve 50 dhe 40 euro shtesë rrezikshmërie në muaj.

Ky vendim nuk është vetëm një fitore sindikale, por një hap i madh drejt një sistemi më të drejtë dhe më të motivuar për të gjithë pjesëtarët e Policisë së Kosovës, që çdo ditë përballen me rrezik për të garantuar rendin dhe sigurinë në vend.

AKTIVITETET SINDIKALE LIDHUR ME SIGURIMIN SHËNDETËSOR-JETËSOR

Nga viti 2022 deri në prill 2025, Sindikata e Policisë së Kosovës ka ndërmarrë një sërë aktiviteteve sindikale për të adresuar mungesën e sigurimit shëndetësor dhe jetësor për pjesëtarët e Policisë së Kosovës. Këto përpjekje përfshijnë deklarata publike, organizim punëtorish, protesta dhe negociata të vazhdueshme me institucionet shtetërore.

Në vitin 2023, Sindikata organizoi punëtorinë me temën "Sigurimi shëndetësor, aksidental dhe jetësor – kur do të jetësohet?", duke theksuar domosdoshmërinë e veprimeve konkrete nga institucionet përkatëse. Po ashtu, më 9 dhjetor 2023, Njësia Speciale Intervenuese dhe njësi të tjera elitare protestuan para Qeverisë së Kosovës, duke paraqitur ndër kërkesat kryesore sigurimin shëndetësor dhe jetësor për pjesëtarët e Policisë së Kosovës. Në vitin 2024, Sindikata vazhdoi reagimet pas një aksidenti, duke kërkuar urgjentisht sigurim shëndetësor për policët.

Pavarësisht përpjekjeve të mëdha të Sindikatës dhe presionit publik, deri në prill 2025 nuk ka hyrë në fuqi një ligj i veçantë për sigurimin shëndetësor dhe jetësor të policëve, megjithëse është premtuar integrimi i kësaj çështjeje në kuadër të një ligji të përgjithshëm për sigurime shëndetësore.

Në kuadër të këtyre përpjekjeve të pandërprera të Sindikatës së Policisë së Kosovës, është arritur një marrëveshje shumë e rëndësishme:

MARRËVESHJA PËR TRAJTIMIN ME PRIORITET SHËNDETËSOR TË POLICISË SË KOSOVËS

Më 6 nëntor 2023, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit mes Policisë së Kosovës dhe Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), e cila garanton që personeli policor dhe rekrutët të trajtohen me prioritet dhe pa pagesë në nivelin dytësor dhe tretësor të shërbimeve shëndetësore, përfshirë të gjitha spitalet rajonale të Kosovës.

Marrëveshja përfshin edhe kujdes të veçantë për shëndetin e grave police, përmes kontrollave të hershme për zbulimin e sëmundjeve si kanceri i gjirit dhe kanceri i qafës së mitrës, si dhe analiza hormonale të specializuara. Zbatimi i marrëveshjes do të monitorohet përmes pikave referuese të vendosura në ShSKUK dhe spitalet rajonale.

Ky rezultat është një dëshmi e qartë e angazhimit dhe punës së vazhdueshme të Sindikatës së Policisë së Kosovës në mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së pjesëtarëve të saj.

ANGAZHIM I PALËKUNDUR NË ÇDO SITUATË – PRANË ZYRTARËVE TANË NË VIJËN E PARË

Sindikata e Policisë së Kosovës, në vazhdimësi dhe me përkushtim të pandërprerë, ka ndjekur nga afër zhvillimet aktuale në vend, duke qenë pranë zyrtarëve policorë në çdo sfidë operationale dhe humane. Gjatë operationeve të ndjeshme të realizuara në veriun e vendit, por edhe në gjithë territorin e Kosovës, kemi qëndruar në krah të çdo zyrtari policor, veçanërisht në rastet kur ata janë përballur me rreziqe të mëdha, lëndime apo humbje jete gjatë kryerjes së detyrës.

Në momentet më të rënda, kur vendi ka humbur bijtë e tij më të devotshëm në uniformë, Sindikata ka reaguar me zë të fuqishëm në media dhe ka ofruar mbështetje të gjithanshme – si morale ashtu edhe materiale – për familjet e tyre, duke qëndruar pranë tyre jo vetëm si përfaqësues sindikal, por si bashkëvuajtës dhe bashkëkombës.

Po ashtu, kemi qenë të zëshëm dhe të vendosur në mbrojtjen e dinjitetit të zyrtarëve tanë në raste të caktuara, si në rastin e arrestimeve të padrejta në pikën kufitare me Serbinë, duke kërkuar drejtësi dhe trajtim të barabartë për ta.

Për më tepër, falë angazhimit tonë të pandalshëm dhe bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm, kemi siguruar ndihmë financiare për një numër të konsiderueshëm zyrtarësh policorë që përballen me sëmundje të rënda, duke treguar se Sindikata është gjithmonë aty kur nevoja është më e madhe.

Në të njëjtën kohë, kemi dënuar me ashpërsinë më të madhe çdo akt dhune apo sulm ndaj zyrtarëve policorë gjatë kryerjes së detyrës, duke reaguar publikisht dhe institucionalisht për të mbrojtur sigurinë, dinjitetin dhe integritetin e çdo pjesëtari të Policisë së Kosovës.

BASHKËPUNIMI ME MENAXHMENTIN DHE AVOKIMI PËR TË DREJTAT E ZYRTARËVE POLICORË

Gjatë gjithë këtyre viteve, Sindikata e Policisë së Kosovës ka ruajtur një bashkëpunim të fuqishëm dhe konstruktiv me menaxhmentin e Policisë së Kosovës, duke qenë gjithmonë pranë kërkesave dhe nevojave të zyrtarëve policorë. Një ndër arritjet më të rëndësishme në këtë drejtim ka qenë angazhimi i sindikatës në çështjen e suspendimeve të zyrtarëve të PK-së.

Në rastet kur zyrtarët policorë janë suspenduar dhe më pas u është rikthyer e drejta për të ushtruar funksionin, Sindikata ka dhënë kontribut të rëndësishëm në hartimin dhe propozimin e udhëzimeve administrative që rregullojnë të drejtat e tyre pas kthimit në punë. Më herët, zyrtarët e kthyer në detyrë pas suspendimit nuk kishin të drejtë të punonin në punë sekondare jashtë detyrës zyrtare, çka konsiderohej si një padrejtësi e dyfishtë.

Falë angazhimit të vazhdueshëm dhe punës intensive të Sindikatës së PK-së, është arritur që kjo pengesë të tejkalohet përmes hartimit të një udhëzimi të ri administrativ. Sot, çdo zyrtar policor që i rikthehet detyrës pas një procesi disiplinor, ka të drejtën të ushtrojë edhe një punë sekondare jashtë orarit të punës, duke ruajtur kështu të drejtat e tij ekonomike dhe sociale.

Ky zhvillim është një dëshmi e qartë e rolit aktiv dhe të palëkundur të Sindikatës në mbrojtje të interesave të zyrtarëve policorë dhe një shembull konkret i fuqisë që ka dialogu institucional dhe bashkëpunimi i ndershëm ndërmjet sindikatës dhe menaxhmentit të PK-së.

VENDIM NË FAVOR TË POLICISË SË KOSOVËS: RIKTHIMI I BENEFITEVE TË FITURA FALË ANGAZHIMIT TË SINDIKATËS

Pas miratimit të Ligjit të Pagave, Sindikata e Policisë së Kosovës, përmes Avokatit të Popullit, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Kushtetuese. Ankesa kishte të bënte me zvogëlimin e shtesës për rrezikshmëri nga 0.50% në 0.25% për vitet e përvojës së punës nga viti i parë deri në vitin e

pesëmbëdhjetë, me heqjen ose uljen e shtesës për kualifikim shkollor, me shtesën e tre pagave për përcjelljen në pension për punonjësit e Policisë së Kosovës, si dhe me një pagë shtesë për rastet e vdekjes së anëtarëve të familjes, krahas shumë benefiteve të tjera që punonjësit i kishin gëzuar përpara miratimit të këtij ligji nga Qeveria e Kosovës.

Gjykata Kushtetuese, pas shqyrtimit të ankesës, ka nxjerrë një vendim përfundimtar, me të cilin ka detyruar Qeverinë e Republikës së Kosovës të rikthejë të gjitha benefitet që punonjësit e Policisë i kishin fituar më herët. Vendimi i Gjykatës përcakton qartë se: Çdo e drejtë e fituar para miratimit të Ligjit të Pagave nuk mund të ulet apo ndryshohet në mënyrë negative, por vetëm të rritet në favor të punonjësve.

Falë angazhimit të vazhdueshëm dhe këmbëngulës të Kryesisë së Sindikatës së Policisë së Kosovës, ky vendim i rëndësishëm u arrit në favor të të gjithë zyrtarëve policorë.

ANGAZHIMI I PANDËRPRERË I SPK-SË PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE FINANCIARE TË PUNONJESVE TE PK-së

Në vazhdim të punës sindikale, Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK) ka kryer pagesën e taksës administrative për gjykatë për çdo anëtar të saj që ka parashtruar ankesë përmes avokatëve për pagën e 13-të, për vitet 2018-2021, të fituar sipas vendimit të Gjykatës Supreme. SPK, në bashkëpunim me partnerë të tjerë, është në vazhdimësi duke punuar dhe kujdesur që këto lëndë të përfundojnë sa më shpejt dhe që policët të realizojnë të drejtën e tyre për pagën e 13-të.

Falë angazhimit të palodhur të Sindikatës së PK-së, një pjesë e punonjesve të Policisë tashmë i kanë marrë këto paga, ndërsa për pjesën tjetër jemi duke vazhduar përpjekjet që pagesat të realizohen sa më shpejt.

Po ashtu, Sindikata e PK-së ka inkurajuar të gjithë zyrtarët policorë që të ngrenë padi civile për kompensim të ditëve të punës gjatë fundjavave, si dhe për rrobat civile për punonjësit që kryejnë detyrat në veshje civile, të cilët, për një kohë të gjatë, janë detyruar të furnizohen me rroba me mjetet e tyre personale pa kompensim nga institucionet përkatëse.

SPK DHE IKD INICOJNË PADI TË PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PUNONJËSVE POLICORË

Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK), në bashkëpunim me Institutin Kosovar për Drejtësi (IKD) dhe në koordinim me sindikatat vendore, pas një pune të gjatë kanë arritur në përfundimin që të formulohet një padi e përgjithshme për të gjithë shërbyesit civilë dhe shërbyesit publikë, ku Policia e Kosovës përfshihet në këtë të fundit.

IKD-ja ka përgatitur një padi të përgjithshme që do të dorëzohet në gjykatat themelore si padi civile për kompensimin e shtesës prej 0.50% të pagës për çdo vit pune, nga viti i parë deri në vitin

e 15-të të përvojës së punës. Kjo padi kolektive ka për qëllim të kursejë buxhetin e shtetit të Kosovës nga një kosto e lartë prej mbi 35 milionë eurosh, e cila do të shkaktohej nga paditë individuale dhe shpenzimet për avokatë dhe përmbarues.

Po ashtu, kjo nismë synon të kursejë kohën dhe angazhimin e punonjësve të Policisë së Kosovës, të cilët, përmes kësaj padie të përbashkët, nuk do të kenë nevojë të bëjnë procedura individuale.

Edhe pse kemi të drejtë të kërkojmë realizimin e të drejtave tona, SPK dhe IKD kanë menduar edhe për interesin e shtetit, duke propozuar një zgjidhje më efikase dhe më pak të kushtueshme për të gjitha palët. Kjo padi përfshin të gjithë punonjësit e institucioneve shtetërore në nivel vendi.

RREGULLIMI I STATUSIT DHE TË DREJTAVE TË ZYRTARËVE POLICORË TË PENSIONUAR

Një ndër arritjet më të rëndësishme të këtij mandati sindikal ka qenë zgjidhja e një çështjeje që prej vitesh ka qenë temë diskutimi dhe kërkesë e vazhdueshme nga ana e zyrtarëve policorë: E drejta për të mbajtur armën personale dhe ID-kartelën si ish-zyrtar policor pas daljes në pension.

Falë angazhimit të pandërprerë dhe punës aktive të Sindikatës së Policisë së Kosovës, si dhe përmes një bashkëpunimi të ngushtë me menaxhmentin e Policisë së Kosovës dhe institucionet përkatëse, kjo e drejtë themelore është tashmë e garantuar me udhëzim administrativ të veçantë.

Sot, çdo pjesëtar i Policisë së Kosovës, pas përfundimit të karrierës dhe daljes në pension, gëzon të drejtën legjitime për të mbajtur një armë personale dhe për të poseduar një ID-kartelë të veçantë që e identifikon si ish-zyrtar policor. Ky zhvillim jo vetëm që simbolizon vlerësimin dhe respektin institucional ndaj kontributit të tyre shumëvjeçar, por gjithashtu përfaqëson një fitore konkrete të sindikatës në mbrojtje të dinjitetit dhe të drejtave të zyrtarëve të pensionuar.

Ky vendim është dëshmi e qartë e rolit të domosdoshëm që luan Sindikata në avancimin e kushteve të punës dhe të jetës së anëtarëve të saj, jo vetëm gjatë shërbimit aktiv, por edhe pas përfundimit të tij.

REAGIMI NDAJ ARRESTIMIT TË ZYRTARËVE POLICORË NË UNIFORMË

Një sfidë tjetër serioze me të cilën është përballur Policia e Kosovës gjatë këtij mandati, ka qenë mënyra e trajtimit të rasteve kur zyrtarët policorë kanë qenë subjekt i hetimeve apo arrestimeve nga ana e Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK). Në disa raste specifike, arrestimet ndaj pjesëtarëve të Policisë janë kryer në mënyrë demonstrative, ndërkohë që ata ndodheshin në krye të detyrës, me uniformë zyrtare dhe në praninë e kolegëve apo qytetarëve. Këto veprime kanë shkaktuar shqetësim të madh brenda trupës policore, duke cenuar rëndë dinjitetin profesional dhe duke krijuar pasiguri të panevojshme në radhët e zyrtarëve të ndershëm që kryejnë detyrat me përkushtim.

Falë angazhimit të menjëhershëm dhe të palëkundur të Kryesisë Ekzekutive të Sindikatës së Policisë së Kosovës, janë ndërmarrë hapa konkretë për të reaguar ndaj këtyre praktikave, përmes deklaratave të fuqishme publike, reagimeve mediatike dhe adresimeve institucionale. Sindikata ka theksuar me vendosmëri se ndonëse askush nuk është mbi ligjin dhe çdo hetim duhet të bëhet në mënyrë profesionale dhe transparente, arrestimet e zyrtarëve policorë duhet të kryhen me respekt të plotë ndaj dinjitetit të tyre dhe jashtë ambienteve të punës apo në mungesë të uniformës zyrtare, për të shmangur çdo perceptim publik të dënimit pa gjykim dhe për të ruajtur integritetin e institucionit të Policisë.

Si rezultat i këtyre përpjekjeve dhe ndërhyrjeve të vazhdueshme nga Sindikata, është rritur ndërgjegjësimi institucional dhe është përforcuar kërkesa për procedura të standardizuara dhe etike në trajtimin e rasteve disiplinore dhe penale ndaj zyrtarëve të PK-së.

Kjo arritje është dëshmi e rolit të pazëvendësueshëm të Sindikatës si mbrojtëse e të drejtave, integritetit dhe dinjitetit të çdo zyrtari policor.

SIGURIMI I PARKIMIT FALAS PËR ZYRTARËT POLICORË NË BASHKËPUNIM ME "PARKING PRISHTINA"

Një tjetër arritje domethënëse gjatë këtij mandati sindikal është përmirësimi i kushteve të parkimit për zyrtarët policorë që punojnë në kryeqytet. Duke pasur parasysh që një numër i madh i zyrtarëve tanë udhëtojnë çdo ditë nga distanca të largëta drejt vendit të punës në Prishtinë, përdorimi i automjeteve private ka qenë i domosdoshëm. Megjithatë, mungesa e hapësirave të përshtatshme për parkim dhe kostot e larta mujore për parking kanë krijuar barrë të konsiderueshme financiare për zyrtarët tanë.

Duke e trajtuar këtë shqetësim si prioritet, Kryesia Ekzekutive e Sindikatës së Policisë së Kosovës ka ndërmarrë hapa konkretë dhe ka realizuar me sukses një marrëveshje me ndërmarrjen publike "Parking Prishtina" dhe Komunën e Prishtinës, për të siguruar mbi 250 vende parkimi falas për zyrtarët policorë. Këto vende janë të dedikuara dhe të aksesueshme sipas orarit të punës së zyrtarëve, duke ofruar kështu një lehtësim real në jetën e tyre të përditshme.

Kjo marrëveshje jo vetëm që ka eliminuar një kosto të përditshme që arrinte deri në 3 euro në ditë për secilin zyrtar, por gjithashtu ka kontribuar në rritjen e moralit dhe efikasitetit të punonjësve tanë, duke ua mundësuar të përqendrohen plotësisht në detyrat e tyre pa pasiguri për vendparkimin.

Kjo është një dëshmi tjetër e qartë se Sindikata e Policisë së Kosovës mbetet e përkushtuar në mbrojtjen dhe përmirësimin e kushteve të punës për çdo pjesëtar të Policisë së Kosovës, në çdo aspekt të përditshmërisë së tyre.

MARRVESHJET NDËRKOMBETARE

Sindikata e Policisë së Kosovës ka realizuar arritje të jashtëzakonshme gjatë periudhës 2022–2025,

duke forcuar pozitat e saj si aktor i rëndësishëm në skenën sindikale ndërkombëtare. Një nga momentet kulmore ishte pranimi i saj si anëtare e barabartë në Këshillin Evropian të Sindikatave Policore (CESP) në maj të vitit 2023, një akt që u mbështet me një votim unanim nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse, përfshirë ato që ende nuk e kanë njohur zyrtarisht Republikën e Kosovës.

Ky antarësim ka hapur dyer të reja për avancimin e të drejtave sociale dhe ligjore të pjesëtarëve të policisë, duke kontribuar në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ngritjen e zërit të Sindikatës në nivel evropian. Në vitin 2024, Sindikata realizoi takimin e parë zyrtar me Unionin e Sindikatave të Pavarura të Policisë së Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës në Sarajevë, duke theksuar angazhimin për shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal. Po ashtu, pjesëmarrja në Konferencën Ndërkombëtare të CESP në vitin 2024, me temën “The New Security Landscape: Future of Policing”, ka ofruar mundësi për prezantimin e sfidave dhe kërkesave aktuale të zyrtarëve policorë të Kosovës.

Në kuadër të aktiviteteve rajonale, Sindikata ka marrë pjesë në Lojërat e 22-ta të Sindikatës së Policisë së Maqedonisë së Veriut, ka kontribuar në themelimin e Shoqatës Ballkanike të Sindikatave të Sektorit të Sigurisë (B.A.T.U.P.S.O) në Bullgari, dhe ka marrë pjesë në aktivitete perkujtimore dhe sportive në Kroaci, duke forcuar lidhjet sindikale dhe promovuar vlerat e solidaritetit. Pjesëmarrja në takime rajonale dhe evropiane, si ato në Maqedoninë e Veriut, ka kontribuar në forcimin e bashkëpunimit dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Këto arritje janë një dëshmi e angazhimit të Sindikatës së Policisë së Kosovës për avancimin e kushteve të punës, mbrojtjen e të drejtave të punonjësve të policisë dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke kontribuar në një mjedis më të sigurt dhe të drejtë për të gjithë.

MARRVESHJET VENDORE

Në kuadër të aktiviteteve sindikale, Sindikata e Policisë së Kosovës, gjatë këtij mandati, ka realizuar një varg marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme, me qëllim të përmirësimit të kushteve të anëtarëve të saj dhe familjeve të tyre.

Këto marrëveshje përfshijnë bashkëpunime me spitale private, klinika shëndetësore, laboratorë të analizave, qendra rehabilituese, institucione të arsimit të lartë (fakultete), banka komerciale, si dhe kompani të derivateve dhe produkteve të konsumit të përditshëm.

Përmes këtyre marrëveshjeve, pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë përfituar lehtësira të ndryshme si zbritje në çmime, qasje më të shpejtë në shërbime, përparësi në trajtime mjekësore, si dhe mundësi tjera që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien dhe jetën e përditshme të tyre.

Këto rezultate janë arritur falë angazhimit dhe përkushtimit të Strukturës Qendrore të Sindikatës së Policisë së Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me kryetarët e njësive rajonale sindikale në të gjitha rajonet e Policisë së Kosovës. Ky bashkëveprim ka qenë thelbësor për arritjen e këtyre

marrëveshjeve dhe përfaqëson një shembull të mirëfilltë të funksionimit të organizuar dhe të bashkërenduar sindikal në shërbim të anëtarësisë.

AKTIVITETET SINDIKALE

Sindikata e Policisë së Kosovës ka vazhduar aktivitetet e saj në stacione dhe drejtoritë policore, duke zhvilluar takime të rëndësishme dhe duke përmirësuar kushtet e punës për punonjësit e Policisë. Këto vizita dhe takime janë pjesë e angazhimeve të sindikatës për të avancuar të drejtat e punonjësve dhe për të forcuar solidaritetin mes anëtarëve të saj. Takimet, të cilat përfshijnë përfaqësues të lartë të sindikatës dhe drejtorë të ndryshëm të Policisë, si dhe anëtarët e njësive sindikale, kanë pasur një fokus të veçantë në përmirësimin e kushteve të punës, sigurimin shëndetësor dhe jetësor për punonjësit, si dhe në zhvillimin e ligjeve të reja që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre. Puna e sindikatës ka sjellë mbështetje të fuqishme nga menaxhmenti dhe autoritetet, duke treguar angazhimin e përbashkët për një mjedis pune më të drejtë dhe më të sigurt.

DONACIONET NË MBËSHTETJE TË ANËTARËVE DHE PAISJEVE TË POLICISË SË KOSOVËS

Në kuadër të angazhimeve të saj të vazhdueshme për përmirësimin e kushteve të punës dhe mirëqenies së anëtarëve, Sindikata e Policisë së Kosovës ka pranuar donacione të ndryshme nga donatorë vendorë dhe ndërkombëtarë. Këto donacione përfshijnë pajisje teknike dhe materiale që kontribuojnë në rritjen e efikasitetit dhe sigurisë në punën e përditshme të policisë. Gjithashtu, janë ofruar ndihma dhe mbështetje direkte për anëtarët sindikalë, duke përfshirë pajisje dhe asistencë në raste të veçanta. Këto kontribute janë dëshmi e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet sindikatës dhe partnerëve të saj, me qëllim për të forcuar kapacitetet operacionale dhe për të siguruar një mjedis pune më të sigurt dhe më të mirë për të gjithë zyrtarët policorë.

MBËSHTETJE E PALODHUR PËR ZYRTARËT POLICORË TË LËNDUAR NË KRYE TË DETYRËS DHE PËR ATA TË PREKUR NGA SËMUNDJE TË REND

Sindikata e Policisë së Kosovës ka demonstruar një angazhim të palëkundur për mirëqenien e anëtarëve të saj, veçanërisht për ata që janë lënduar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare. Në çdo rast të lëndimit, Sindikata ka qëndruar pranë tyre, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme dhe duke u angazhuar maksimalisht për stabilizimin e gjendjes së tyre shëndetësore. Vizitat e shpeshta në spitale, sigurimi i ndihmës ligjore dhe mbështetje psikologjike janë disa nga veprimet konkrete që Sindikata ka ndërmarrë për të siguruar që zyrtarët policorë të lënduar të ndihen të mbrojtur dhe të vlerësuar. Ky angazhim i pandërprerë është një dëshmi e përkushtimit të Sindikatës për të mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e anëtarëve të saj në çdo situatë.

MBËSHTETJE E GJITHANSHME PËR ANËTARËT TANË NË ASPEKTIN SOCIAL, FINANCIAR DHE PSIKOLOGJIK SIPAS KRITERVE UNIKE TE SINDIKATËS SË POLICISË SË KOSOVËS

Një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë së Sindikatës së Policisë së Kosovës ka qenë dhe mbetet mbështetja e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse për anëtarët tanë, në çdo rrethanë personale apo familjare. Në këtë drejtim, Sindikata ka vendosur bashkëpunime dhe kontrata të posaçme me qendra rehabilituese dhe institucione shëndetësore, duke siguruar shërbime me çmime të ulta dhe të përballueshme, për të garantuar mirëqenie fizike për zyrtarët tanë.

Po ashtu, Sindikata ka ofruar ndihma të drejtpërdrejta financiare për anëtarët që janë përballur me vështirësi të papritura ekonomike, si dhe mbështetje morale dhe emocionale për familjet e zyrtarëve që kanë humbur të afërmit e tyre, duke qenë pranë tyre në momentet më të ndjeshme dhe të vështira të jetës.

Ky angazhim i palëkundur është dëshmi e qartë se Sindikata nuk është vetëm një organizatë përfaqësuese, por një familje e madhe solidariteti, që kujdeset për çdo pjesëtar të saj me zemër, përkushtim dhe ndjeshmëri të lartë njerëzore.

LOJRAT SPORTIVE NE KUADER TE AKTIVITETEVE SINDIKALE

Në kuadër të aktiviteteve sindikale, Sindikata e Policisë së Kosovës ka organizuar çdo vit turneun tradicional sportiv në nderim të zyrtarëve policorë të rënë në krye të detyrës. Ky aktivitet është një shprehje e përkushtimit për të nderuar kolegët e ndjerë dhe për të promovuar vlerat e bashkëpunimit, solidaritetit dhe shëndetit fizik ndërmjet anëtarëve të sindikatës.

Turneu sportiv është bërë një ngjarje e rëndësishme në kalendarin e Sindikatës, duke tërhequr pjesëmarrjen e gjerë të drejtuesve të lartë institucionalë dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë. Në keto aktivite kanë marrë pjesë Drejtori i Policisë së Kosovës, ministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfaqësues nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, përfaqësues të KFOR-it, Ushtrisë së Kosovës, kryetarë dhe përfaqësues të sindikatave rajonale, si dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Evropian të Sindikatave të Policisë (CESP).

Keto turne sportiv jo vetëm që nderojnë kujtimin e zyrtarëve të rënë, por gjithashtu forcojnë lidhjet ndërmjet anëtarëve të sindikatës dhe institucioneve të tjera, duke kontribuar në ndërtimin e një mjedisi pune më të bashkuar dhe më të shëndetshëm.

Këto aktivitete janë një dëshmi e përkushtimit të Sindikatës së Policisë së Kosovës për të mbështetur anëtarët e saj dhe për të promovuar një kulturë të respektit dhe bashkëpunimit brenda forcës policore.

AKTIVITETET E SHOQATAVE SINDIKALE

Në kuadër të aktiviteteve të saj të vazhdueshme, Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK), me

përkushtim të madh punon për mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave të anëtarëve të saj. Duke ndjekur misionin sindikal dhe angazhimin në promovimin e mirëqenies së zyrtarëve policorë, SPK ka organizuar dhe mbështetur aktivitete të shumta në nivel qendror dhe rajonal. Kryetarët e shoqatave sindikale, në vazhdimësi, kanë organizuar aktivitete të ndryshme për anëtarët e tyre, me qëllim forcimin e lidhjeve ndërmjet anëtarëve sindikalë, ngritjen e vetëdijes për të drejtat e tyre, nxitjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe promovimin e vlerave sindikale. Ndër aktivitetet e realizuara përfshihen ekskursionet, shëtitje rekreative, lojëra sportive dhe veprimtari të tjera që synojnë krijimin e një fryme pozitive, bashkëpunuese dhe motivuese mes anëtarëve sindikalë, duke kontribuar në mirëqenien fizike dhe emocionale të tyre.

Këto aktivitete pasqyrojnë angazhimin e Sindikatës së Policisë së Kosovës në avancimin e të drejtave të zyrtarëve policorë dhe në krijimin e një ambienti profesional, të drejtë dhe përfshirës për të gjithë anëtarët e saj.

LIGJI I PAGAVE DHE SHITESAT NË PAGË

Sindikata e Policisë së Kosovës ka qenë e angazhuar vazhdimisht që nga krijimi i mekanizmave të saj, duke mbajtur një raport të ngushtë dhe të vazhdueshëm me Qeverinë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme. Gjatë këtyre viteve, Sindikata ka punuar dhe ka propozuar në mënyrë të veçantë për përmirësimin e ligjit të pagave dhe shtesave në pagë, duke qenë një zë i fuqishëm në këtë drejtim. Aktivitetet e saj të vazhdueshme kanë pasur një ndikim të rëndësishëm, ku Kryesia Ekzekutive e Sindikatës ka paraqitur kërkesat dhe arsyet, dhe ato janë marrë në konsideratë. Falë përpjekjeve të Sindikatës së Policisë së Kosovës, është arritur që koeficienti për zyrtarët policorë të jetë në përputhje me kërkesat dhe standardet e kërkuara, duke reflektuar kështu angazhimin dhe meritat e Sindikatës në këtë fushë.

Në vazhdim të angazhimit të pandërprerë të Sindikatës së Policisë së Kosovës për të përmirësuar kushtet e punës dhe të drejtat e pjesëtarëve të Policisë, Këshilli Drejtues ka mbajtur takime të rregullta për analizimin e shqetësimeve të shprehura nga anëtarët, si dhe ka adresuar kërkesat e tyre në institucione të ndryshme shtetërore. Gjatë këtyre diskutimeve, u theksua rëndësia e ekzekutimit të shtesës së rrezikshmërisë, rishikimit të pagave, dhe përmirësimit të kushteve të përgjithshme të punës për të gjithë pjesëtarët e Policisë së Kosovës. Për më tepër, sindikata ka kërkuar ndryshime të nevojshme në legjislacionin dhe zbatimin e aktgjyqimeve të rëndësishme që kanë për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurisë për stafin policor dhe civil.

Në kuadër të ligjit të pagave, pas miratimit të propozimeve të Sindikatës për Policinë e Kosovës, shtojca nr. 5 është kategorizuar sipas kërkesave tona. Më poshtë do të gjeni edhe shtojcën e aprovuar.

Në vazhdim, paraqesim reagimet e Sindikatës, të cilat reflektojnë angazhimin e saj të palodhur për mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve dhe për sigurimin e kushteve të domosdoshme që mundësojnë kryerjen e detyrave të tyre me dinjitet dhe siguri.

LIGJI I PAGAVE DHE SHITESAT NE PAGE

Më datë 25.03.2024, Kryesia Ekzekutive e Sindikatës së PK-së u pritën në takim nga Ministri i MPB-së z.Xhela Sveçla dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës Kolonel Gazmend Hoxha.

Gjatë këtij takimi, janë diskutuar të gjitha kërkesat e Sindikatës të cilat janë paraqitur edhe më herët në takimet paraprake.

Nga Ministri i MPB-së z. Xhelal Sveçla jemi informuar për të arriturat sa i përket përmirësimit të kushteve të përgjithshme të punës dhe mirëqenies në Policinë e Kosovës. Rezultate pozitive u vlerësuan investimet kapitale në infrastrukturë të objekteve, pajisjeve policore dhe logjistike, automjetet dhe investimet tjera të nevojshme për kryerjen e detyrave policore me efikasitet në mbrojtje të rendit, qetësisë publike dhe integritetit të vendit.

Sa i përket kushteve dhe mirëqenies së pjesëtarëve të policisë, Ministri na informoj se kërkesat që janë paraqitur nga sindikata, disa prej tyre janë në procedurë të realizimit siç është Ligji për Sigurim Shëndetësorë, Ligjit për pensionim në moshën 55 vjeçare në Policinë e Kosovës, kërkesa për staf deficitar që për këtë është formuar një komision Qeveritar dhe do të dalin me një vlerësim konkretë në kohë sa më optimale.

Po ashtu nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës Kolonel Gazmend Hoxha, u njoftuam edhe për realizimin e transportit për të gjithë pjesëtarët e policisë që udhëtojnë larg nga vendbanimi i tyre, se deri në Muajin Qershor të këtij viti do të kompletohen me disa minibus të rinjë për transportin në relacione të gjata në gjithë vendin.

Sa i përket shtesës në pagë, përvojës së punës dhe aty ku ka pasur zbritje page për të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës, për këtë çështje do të zbatohet Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese për të cilën u deklarua edhe Ministri se do të zbatohet çdo vendim i gjykatës.

Po ashtu Ministri i MPB-së u zotua se në suaza të kushteve dhe mundësive buxhetore do të punojë në përmirësimin e kushteve dhe mirëqenies në Policinë e Kosovës.

Nga Sindikata u shpreh edhe shqetësimi i proceduarve hetimore që po i ndjekin Inspektorati Policorë i Kosovës ndaj zyrtarëve policorë, sidomos hetimi për masa disiplinore.

Nga ky takim dolëm me dakordimin që të kemi takime të vazhdueshme drejt realizimit të kërkesave të Sindikatës së Policisë së Kosovës për të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës.

Më datë 06.02.2024, Kryesia ekzekutive e Sindikatës së PK-së, lidhur me peticionin e dërguar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, kanë raportuar në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione.

Në këtë takim nga Kryetari dhe Nënkryetari janë paraqitur kërkesat të cilat kanë qenë të shkruara në peticion, duke u arsyetuar të gjitha edhe me bazë ligjore. Po ashtu janë përgjigjur edhe në pyetjet e deputetëve që kanë qenë në takim.

Nga Kryetarja e Komisionit znj.Duda Balje ka premtuar se këto kërkesa do të shqyrtohen dhe komisioni do të dalë me një konkluzion në kohë sa më optimale.

Takim pune me Njësitë e Specializuara të Policisë së Kosovës në Kampin “Enver Zymeri” në Mitrovicë

Më datë 01.02.2024, Kryesia ekzekutive e Sindikatës së PK-së dhe Kryetari i Shoqatës Sindikale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, kanë mbajtur një takim pune me Njësitë e Specializuara të Policisë së Kosovës, në Kampin “Enver Zymeri” në Mitrovicë.

Në këtë takim kanë marrë pjesë përfaqësuesit e njësive të: NJSO-së, NJSI-së, NJTME-së, NJMA-së dhe K-9.

Qëllim i takimit ishte koordinimi dhe përfaqësimi sa më i mirë i të drejtave të të gjithë punonjësve të Policisë së Kosovës.

Kryetari i Sindikatës fillimisht paraqiti veprimet dhe punën e deritashme të Sindikatës dhe planifikimin në të ardhmen sa i përket mbrojtjes së të drejtave të pjesëtarëve të policisë dhe realizimit të kërkesave.

Në këtë takim, nga të pranishmit, janë diskutuar kushtet e punës, pajisjet, mirëqenia, shkelja e të drejtave ligjore të punëtorëve, heqja e disa kufizimeve të paarsyeshme, kompetencat e njësive dhe trajtimi i dinjitetshëm për të gjithë pjesëtarët e policisë.

Nga përfaqësuesit e këtyre njësive është kërkuar që Sindikata të luaj rol vendimtar në përfaqësimin e të drejtave të tyre, qoftë në kushte dhe mirëqenie, qoftë në rregullimin e disa çështjeve administrative si të Udhëzimet dhe Rregulloret e brendshme. Po ashtu kërkesë e veçantë ishte reflektimi, brenda muajit Shkurt, për realizimin e kërkesave të paraqitura në protestën e fundit, me qëllim që të mos detyrohemi që të fillojmë përsëri me protesta.

Kryetari i Sindikatës është zotuar se në mënyrë të pa anshme dhe pa ndikim nga askush do të përfaqësoj të gjithë punonjësit e policisë duke insistuar që të drejtat dhe kërkesat e tyre të realizohet me dialog dhe mirëkuptim nga organet përkatëse.

Më 20.12.2023, Kryesia Ekzekutive e Sindikatës së Policisë së Kosovës zhvilloi një takim me Ministrin e Punëve të Brendshme z. Xhelal Sveçla në të cilin mori pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Kolonel Gazmend Hoxha.

Në këtë takim u diskutua për situatën aktuale, gjendjen ekonomike të pjesëtarëve të PK-së, si dhe për kushtet e punës në Policinë e Kosovës.

Takimi karakterizohet si përmbajtësor dhe konstruktiv.

Ministri Sveçla shprehu gatishmërinë për bashkëpunim me Sindikatën e Policisë së Kosovës, menaxhmentin e Policisë së Kosovës dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme për trajtimin e kërkesave të paraqitura me shkrim, duke synuar ngritjen e mirëqenies së çdo pjesëtari të Policisë së Kosovës dhe përmirësimin e kushteve të punës.

Sindikata e Policisë së Kosovës gjithmonë ka përkrahur dialogun social me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe përfaqëson të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës. Në takim u trajtuan edhe çështje të tjera të rëndësishme për përmirësimin e kushteve dhe mirëqenies në Policinë e Kosovës. Sindikata e Policisë së Kosovës

Mbledhja e Këshillit Drejtues të Sindikatës së Policisë së Kosovës

Në këtë mbledhje u diskutua për protestën e mbajtur me datë 09.12.2023 bashkë me NJSI dhe njësitë e tjera policore nga rajonet tjera.

Në këtë takim u vlerësua se protesta është menaxhuar mirë dhe e ka arritur efektin e vet me kërkesat e paraqitura.

Ndërsa për hapat tjerë, Këshilli Drejtues vendosi që në muajin Janar të vitit të ardhshëm të mbahet një takim i KD-së dhe të shikohet se në këtë periudhë kohore, nga protestat e deri në mbledhjen e ardhshme a do të realizohet ndonjë takim në drejtim të dialogut social.

Arsyeja e kësaj periudhe kohore është për të dhënë hapësirë për dialog dhe pasi që është fundi i vitit si dhe për shkak të festave që pasojnë nuk mund të realizohet ndonjë aktivitet sindikal.

Në mbledhjen mbajtur me datë 30.10.2023, Këshilli Drejtues i Sindikatës së Policisë së Kosovës, pasi analizoj zhvillimet e fundit duke përfshirë edhe propozimin e Qeverisë për shtesat për rrezikshmëri, lëshon këtë komunikatë për media.

Sindikata e Policisë së Kosovës përkrahë të gjitha kërkesat e arsyeshme dhe legjitime të secilit zyrtarë policorë dhe punonjëseve tjerë mbështetës të Policisë së Kosovës.

Sa i përket propozimit të Qeverisë për shtesat e rrezikshmërisë, vlerësojmë se janë të ulta dhe nuk e arsyetojnë punën dhe rrezikshmërinë në Policinë e Kosovës, prandaj janë të pa pranueshme për secilën kategori, janë diskriminuese për të gjitha njësitë, sepse të gjithë zyrtarët policorë përballen çdo ditë me rrezik dhe kjo e dëshmon me numrin e zyrtarëve policorë që e kanë humbur jetën gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

Sindikata e Policisë së Kosovës mbron interes e të gjithë pjesëtarëve të policisë me qëllim të përmirësimit të mirëqenjes dhe kushteve për punë, këtë e bënë në mënyrë të organizuar, në konsultim dhe koordinim me anëtarësinë e vet.

Nga takimi i mbajtur, Këshilli Drejtues doli me këto kërkesa:

1. Shtesa për rrezikshmëri të mos mbetet më e ulët se ajo që është pranuar para hyrjes në fuqi të Ligjit të Pagave, që ka qenë në shtatë nivele duke filluar nga 105 euro dhe më larta 215 euro, ose me përqindje në pagën bazë duke filluar nga 25% deri në 50%.

2. Ndërsa për stafin civil, koeficienti të harmonizohet me vendin e punës dhe profesionet që i kryejnë.

Pakënaqësia te të gjithë pjestarët e policisë është e madhe, prandaj kërkojmë që në afat sa më të shkurtë të bëhet realizimi i këtyre kërkesave dhe kërkesave paraprahe me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe mirëqenjes në Policinë e Kosovës.

Sindikata e Policisë së Kosovës, sot me datë 18.07.2023, ka dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës Peticionin e nëshkruar nga punonjësitë e Policisë së Kosovës lidhur me pakënaqësitë e tyre, : Ligjin e pagave, sigurimin shëndetësorë dhe jetësorë , Ligji e pensionimit , shtesa për punë specifike dhe rrezikshmëri si dhe kushtet e punës.

Sindikata e Policisë së Kosovës njofton punonjësitë e Policisë së Kosovës dhe opinionin e gjerë se ky është njëri nga hapat sindikal drejt realizimit të kërkesave tona ligjore.



Duke u bazuar në dy komunikatat e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të muajit shkurt dhe muajit mars me arsyetimin dhe premtimin se Qeveria e Republikës së Kosovës në pagën muajin maj në menyre retroaktive do të ekzekutoj pagesën e rrezikshmerisë për të gjithë zyrtarët policor ku per fat te keq ky premtim nuk u realizua as në këtë muaj, Sindikata e Policisë së Kosovës ka pranuar dhe vazhdon të pranoj vërejtje dhe ankesa nga të gjitha njësitë në kuadër të Policisë së Kosovës per mos realizimin e shtesës së rrezikshmerisë edhe në këtë muaj si dhe pagësën retroaktive për muajin shkurt dhe mars si dhe ankesat nga njësitet e stafit civil që punojnë në kuadër të PK-së që kanë të bëjnë me kategorizimin ku pritshmeritë kanë qenë të mëdha që shtesa e rrezikshmerisë dhe kategorizimi do të dalin me pagën e muajit prill dhe për muajt paraprak.

Andaj Kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që shtesat e rrezikshmerisë për të gjithë zyrtarët policorë, dhe kategorizimin e disa profesioneve të Stafit Civil dhe mbështetës pa asnjë përjashtim, të realizohen me pagën e muajit Maj ne fillim te Qershorit dhe në asnjë rast të mos ketë shtyrje ne realizimin e së drejtës për të gëzuar të drejtën në shtesën e rrezikshmerisë.

Sindikata e Policisë së Kosovës shpreson se Qeveria e Republikës së Kosovës do të reflektoj dhe pa humbur kohë do ta realizoj shtesën e rrezikshmerisë si e drejtë elementare dhe e merituar në të kunderten e mos ralizimit të kësaj kërkesë siç po ndodh edhe me kërkesat tjera qe ia kem parashtruar deri me tani Qeverisë, ne si Sindikatë jemi të detyruar që të ndërmarrim masat sindikale bazuar në ligjin mbi organizimin sindikal dhe ligjin e Policisë së Kosovës për ti realizuar të drejtat tona në plotësimin e kërkesave tona.

Të nderuar anëtarë të këshillit drejtues dhe përfaqësues të DMO-së dhe Flotës

Ju njoftojmë se pas mbledhjes së Këshillit Drejtues të datës 03.03.2023 dhe analizimit të pakënaqësive lidhur me pagat, ligjin e pagave, klasifikimin për stafin civil dhe shtesën e rrezikshmerisë për zyrtarët policor, ne dolëm me konkluzionet dhe kërkesat e qarta për Qeverinë e Kosovës të cilat janë drejtuar me shkrim te Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ministri i financave, Ministri i MPB-së dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Afati i kërkesave tona për reflektimin e Qeverisë ishte data 10.03.2023.

Andaj lidhur me kërkesat tona, Qeveria e Republikës së Kosovës ka reflektuar menjëherë duke kërkuar nga menaxhmenti i lartë i policisë që brenda institucionit policor të formojë grupin punues që të merret me vërejtjet dhe kërkesat e sindikatës me qëllim të përmirësimit të klasifikimit te njësitë e stafit civil dhe vlerësimit të rrezikshmerisë te zyrtarët policorë.

Kryesia ekzekutive e sindikatës ju njofton se gjatë tërë javës e kemi përcjellë punën e grupit punues, kemi qenë në kontakt me ata dhe me të gjithë të pakënaqurit nga të cilët kemi pranuar ankesat me shkrim dhe verbalisht, të cilat i kemi përcjellë edhe te menaxhmenti policor dhe te grupi punues.

Ne, me datë 08.03.2023, jemi njoftuar se është punuar dhe përfunduar lista me kërkesa dhe përmirësime për shtesën e rrezikshmërisë e cila është dërguar në MPB dhe është konfirmuar se rrezikshmëria do të ekzekutohet në mënyrë retroaktive edhe për muajin Shkurt për të gjithë.

Me datë 09.03.2023 po ashtu jemi njoftuar se është punuar dhe dërguar, në MPB, lista për stafin civil me kërkesat për përmirësim të klasifikimit dhe shtesave tjera për punë të veçanta.

Andaj duke parë se kërkesat tona kanë qenë të arsyeshme dhe serioze, MPB ka dalë me një njoftim publik duke njoftuar se ka filluar punën në korrigjimin e mospërputhjeve eventuale ndërmjet klasifikimeve që kanë qenë duke u zbatuar në sistemin e vjetër dhe në këtë që ka filluar së zbatuari në muajin Shkurt (shih njoftimin nga MPB-ja në bashkëngjitje).

Pas reflektimit të Qeverisë dhe MPB-së, konsiderojmë se kemi marr përgjegje në kohën optimale dhe jemi të obliguar që të presim deri me pagën e muajit Mars, ose deri në pranimin e ndonjë informate të saktë rreth zhvillimeve lidhur me kërkesat tona, por asnjëherë duke mos u ndalur në angazhimin tonë të përbashkët deri në realizimin e kërkesave tona.

Nga ju, anëtarët e këshillit drejtues dhe përfaqësuesit e DMO-së dhe Flotës, kërkojmë që t'i njoftoni të gjithë përfaqësuesit e stacioneve policore dhe njësisive sindikale në kuadër të përgjegjësive të juaja.

Në vazhdim gjeni njoftimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Brendshme

Njoftim lidhur me procesin e korrigjimit/ përshtatjes së mospërputhjeve eventuale ndërmjet sistemit të vjetër të pagave dhe sistemit të ri të pagave, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L – 196 për Pagat në Sektorin Publik

Në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 04/128 të datës 16.02.2023, Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve/Thesari i Shtetit, ka filluar punën në korrigjimin e mospërputhjeve eventuale ndërmjet klasifikimeve që kanë qenë duke u zbatuar në sistemin e vjetër dhe në këtë që ka filluar së zbatuari në muajin shkurt e që rrjedhë nga pasojat juridike të hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L – 196 për Pagat në Sektorin Publik.

Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (MPB/DMZP), njofton të gjitha palët se me kohë ka dërguar njoftim me shpjegimet përkatëse në të gjitha njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore, ku është bërë e njohur procedura, adresa ku dorëzohen kërkesat, dokumentet e nevojshme që mbështesin kërkesat/pretendimet e palëve etj. Në këtë adresim, është prezantuar adresa elektronike zyrtare ku dorëzohen kërkesat (info.dmzp@rks-gov.net), në të cilën, njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore, janë udhëzuar që të bëjnë përmbledhjen e kërkesave individuale për të cilat kërkohet rishikim dhe eventualisht korrigjim i mospërputhjeve dhe më pas, dorëzim të kërkesave të përmbledhura në DMZP, nga njësitë e burimeve njerëzore. Për lehtësi dhe efikasitet, kërkohet që maksimalisht kërkesat në DMZP, të dorëzohen të përmbledhura përmes njësisive përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Për atë që kanë ndodhur mospërputhje, DMZP njofton opinionin se të gjitha pasaktësitë që nuk janë shkaktuar nga mungesa e klasifikimit të vendeve të punës, në përputhje me Ligjin Nr.08/L – 196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Vendimin e Qeverisë Nr. 04/128 të datës 16.02.2023, do të korrigjohen dhe të gjitha vlerat e minusuara nga mospërputhjet, do të kompensohen në mënyrë

retroaktive. Nga ana tjetër, të gjitha pretendimet për gabime që rrjedhin si pasojë e mungesës së akteve të brendshme mbi klasifikimin e vendeve të punës nëpër institucionet që ndikohen nga Ligji Nr.08/L – 196 për Pagat në Sektorin Publik, do të adresohen në procesin e përmbylljes së klasifikimit të vendeve të punës në institucionet publike në momentin e miratimit dhe hyrjes në fuqi të tyre.

MPB do të mbajë të informuar opinionin deri në përmbylljen e procesit për aq sa është shpjeguar më lartë.

Duke u bazuar në pakënaqësitë e shprehura nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës lidhur me pagat e muajit shkurt, sot më datë 03.03.2023 Këshilli Drejtues i Sindikatës së PK-së ka mbajtur takim me qëllim të analizimit të ankesave dhe kërkesave të pjesëtarëve të PK-së duke filluar nga zyrtarët policorë dhe njësitë e stafit civil që punojnë në kuadër të PK-së

Në këtë takim, përveç anëtarëve të Këshillit Drejtues të Sindikatës kanë marr pjesë edhe përfaqësuesit nga Flota Operative, Logjistika dhe Drejtoria për menaxhimin e objekteve policore, të cilët para Këshillit Drejtues kanë paraqitur pakënaqësitë dhe ankesat e tyre. Po ashtu Sindikata e Policisë së Kosovës ka pranuar vërejtje dhe ankesa edhe nga njësitë tjera në kuadër të Policisë së Kosovës të cilat u prezantuan para Këshillit Drejtues.

Pakënaqësitë dhe ankesat e parashtruara para KD kanë qenë si:

1. Zvogëlimi i pagës neto në disa sektor dhe nivele të ndryshme në kuadër të PK-së
2. Mos pagesa e shtesës së rrezikshmërisë për Zyrtarët Policorë
3. Mos pagesa e shtesave për kushte të veçanta dhe specifike të punës për disa kategori të Stafit Civil (punonjësit në PK)
4. Pakënaqësitë në kategorizimin e disa profesioneve të Stafit Civil dhe mbështetës.
5. Mos përfillja e listës së dërguar nga komisioni i menaxhmentit policor për kategorizimin e profesioneve të ndryshme në PK.

Pas dëgjimit të këtyre pakënaqësive dhe analizimit, Këshilli Drejtues nxori këto kërkesa dhe konkluzione:

1. Kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që shtesat e rrezikshmërisë për të gjithë zyrtarët policorë, pa asnjë përjashtim, të realizohen me pagën e muajit mars dhe në asnjë rast të mos ketë zbritje gjatë kategorizimit nga ajo që ka qenë deri më tani, gjegjësisht para hyrjes në fuqi të Ligjit të Pagave dhe në mënyrë retroaktive të kompensohet edhe shtesa e muajit shkurt.
2. Kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të realizoj shtesat për stafin civil në PK, ashtu siç i kanë realizuar deri më tani para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe gjithashtu të ketë shtesa për punë specifike dhe për kushte të veçanta të punës.
3. Kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që stafin civil ta kategorizojë sipas listës së dërguar nga Policia e Kosovës
4. Po ashtu, kërkesë e veçantë është që një përfaqësues i sindikatës të merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në komisionin për caktimin e rrezikshmërisë dhe shtesave të veçanta për kushtet specifike të punës.

Duke u bazuar në konkluzionet e sipërpërmendura kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që më së largu deri në fund të javës së ardhshme të marrim përgjigje në kërkesat tona në të kundërtën jemi të obliguar që të shqyrtojmë të gjitha mundësitë dhe hapat e tjera sindikal të parapara me ligj.

Sindikata e Policisë së Kosovës me datë 03.02.2023 ka dërguar Kërkesës për inicim të vlerësimit të kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L – 196 për pagat në Sektorin Publik tek Avokati I Popullit lidhur me shqetësimet për Ligjin e Pagave, përkatësisht: Neni 26 Shtesat për kushte specifike të punës (shtesat e rrezikshmërisë), Nenin 35 dhe 36 Kompensimet, kompensimi për kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës, Neni 44 Shtojcat e Ligjit, Shtojca Nr.5.1 – Policia e Kosovës dhe Shtojca nr, 10.6 e Projektligjit – nëpunësit e shërbimit civil, nëpunësi i administratës së shërbimit publik dhe nëpunësi teknik dhe mbështetës.

Ju njoftojmë së 13 Shkurt 2023, Nga avokati i Popullit kemi marrë njoftimin ku ka vendosur si të pranueshme ankesën, për hetimin e shkeljeve eventuale të pohuara. Ne vijim gjeni shkresën e bashkangjitur nga Avokati i Popullit.

Sot me 14.12.2022 është mbajtur takimi me Ministrin e Financave, Z. Hekuran Murati, në këtë takim kanë marrë pjesë kryetarët e Sindikatave: nga Policia, Arsimi, Administrata, Shëndetësia dhe Dogana.

Në këtë takim kryesisht është diskutuar rreth digjitalizimit të anëtarësisë sindikale në platformën E-Kosova, mangësitë dhe përparësitë e platformës dhe është kërkuar nga ministri që të kthej gjendjen e mëparshme të anëtarësisë dhe të ipet kohë për mundësinë e digjitalizimit në mënyrë që të kthehet funksionalizimi normal i Sindikatave.

Gjithashtu është diskutuar edhe për Ligjin e pagave dhe miratimin e kërkesave nga Sindikatat si dhe koha e implementimit.

Ministri, Z. Murati premtoj se do të bëjë një zgjidhje që Sindikatat të funksionojnë normalisht duke pasur parasysh për kërkesat që dolën gjatë takimit. Sa i përket Ligjit të pagave, ai tha se është në procedurën e miratimit nga Kuvendi dhe është duke u punuar që sa me shpejt të behet implementimi i tij.

AKTIVITETET SINDIKALE LIDHUR ME SIGURIMIN SHËNDETËSOR - JETËSOR

Nga viti 2022 deri në prill 2025, Sindikata e Policisë së Kosovës ka ndërmarrë një sërë aktiviteteve sindikale për të adresuar mungesën e sigurimit shëndetësor dhe jetësor për pjesëtarët e Policisë së Kosovës. Këto përpjekje përfshijnë deklarata publike, organizim punëtorish, protesta dhe negociata të vazhdueshme me institucionet shtetërore.

Në vitin 2023, Sindikata organizoi punëtorinë me temën "Sigurimi shëndetësor, aksidental dhe jetësor – kur do të jetësohet?", duke theksuar domosdoshmërinë e veprimeve konkrete nga institucionet përkatëse. Po ashtu, më 9 dhjetor 2023, Njësia Speciale Intervenuese dhe njësi të tjera elitare protestuan para Qeverisë së Kosovës, duke paraqitur ndër kërkesat kryesore sigurimin shëndetësor dhe jetësor për pjesëtarët e Policisë së Kosovës. Në vitin 2024, Sindikata vazhdoi reagimet pas një aksidenti, duke kërkuar urgjentisht sigurim shëndetësor për policët.

Pavarësisht përpjekjeve të mëdha të Sindikatës dhe presionit publik, deri në prill 2025 nuk ka hyrë në fuqi një ligj i veçantë për sigurimin shëndetësor dhe jetësor të policëve, megjithëse është premtuar integrimi i kësaj çështjeje në kuadër të një ligji të përgjithshëm për sigurime shëndetësore.

Në kuadër të këtyre përpjekjeve të pandërprera të Sindikatës së Policisë së Kosovës, është arritur një marrëveshje shumë e rëndësishme:

MARRËVESHJA PËR TRAJTIMIN ME PRIORITET SHËNDETËSOR TË POLICISË SË KOSOVËS

Më 6 nëntor 2023, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit mes Policisë së Kosovës dhe Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), e cila garanton që personeli policor dhe rekrutët të trajtohen me prioritet dhe pa pagesë në nivelin dytësor dhe tretësor të shërbimeve shëndetësore, përfshirë të gjitha spitalet rajonale të Kosovës.

Marrëveshja përfshin edhe kujdes të veçantë për shëndetin e grave police, përmes kontrollave të hershme për zbulimin e sëmundjeve si kanceri i gjirit dhe kanceri i qafës së mitrës, si dhe analiza hormonale të specializuara. Zbatimi i marrëveshjes do të monitorohet përmes pikave referuese të vendosura në ShSKUK dhe spitalet rajonale.

Ky rezultat është një dëshmi e qartë e angazhimit dhe punës së vazhdueshme të Sindikatës së Policisë së Kosovës në mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së pjesëtarëve të saj.

MARRVESHJET NDËRKOMBËTARE

Sindikata e Policisë së Kosovës ka realizuar arritje të jashtëzakonshme gjatë periudhës 2022–2025, duke forcuar pozitat e saj si aktor i rëndësishëm në skenën sindikale ndërkombëtare. Një nga momentet kulmore ishte pranimi i saj si anëtare e barabartë në Këshillin Evropian të Sindikatave Policore (CESP) në maj të vitit 2023, një akt që u mbështet me një votim unanim nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse, përfshirë ato që ende nuk e kanë njohur zyrtarisht Republikën e Kosovës.

Ky antarësim ka hapur dyer të reja për avancimin e të drejtave sociale dhe ligjore të pjesëtarëve të policisë, duke kontribuar në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ngritjen e zërit të Sindikatës në nivel evropian. Në vitin 2024, Sindikata realizoi takimin e parë zyrtar me Unionin e Sindikatave të Pavarura të Policisë së Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës në Sarajevë, duke theksuar angazhimin për shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal. Po ashtu, pjesëmarrja në Konferencën Ndërkombëtare të CESP në vitin 2024, me temën “The New Security Landscape: Future of Policing”, ka ofruar mundësi për prezantimin e sfidave dhe kërkesave aktuale të zyrtarëve policorë të Kosovës.

Në kuadër të aktiviteteve rajonale, Sindikata ka marrë pjesë në Lojërat e 22-ta të Sindikatës së Policisë së Maqedonisë së Veriut, ka kontribuar në themelimin e Shoqatës Ballkanike të Sindikatave të Sektorit të Sigurisë (B.A.T.U.P.S.O) në Bullgari, dhe ka marrë pjesë në aktivitete përkujtimore dhe sportive në Kroaci, duke forcuar lidhjet sindikale dhe promovuar vlerat e solidaritetit. Pjesëmarrja në takime rajonale dhe evropiane, si ato në Maqedoninë e Veriut, ka kontribuar në forcimin e bashkëpunimit dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Këto arritje janë një dëshmi e angazhimit të Sindikatës së Policisë së Kosovës për avancimin e kushteve të punës, mbrojtjen e të drejtave të punonjësve të policisë dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke kontribuar në një mjedis më të sigurt dhe të drejtë për të gjithë.

Sindikata e Policisë së Kosovës pranohet në Këshillin Evropian të Sindikatave Policore (CESP)

Një nga arritjet më të mëdha dhe historike për Sindikatën e Policisë së Kosovës gjatë periudhës raportuese 2021–2025 është antarësimi i saj në Këshillin Evropian të Sindikatave Policore (CESP).

Në datat 16 dhe 17 maj 2023, në kongresin e komisionit ekzekutiv të mbajtur në Romë të Italisë, një nga pikat kryesore të rendit të ditës ishte votimi për pranimin e Sindikatës së Policisë së Kosovës si anëtare e barabartë në këtë këshill prestigjioz evropian. Ky moment historik u përmyll me një votim unanim nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse, përfshirë edhe ato që ende nuk e kanë njohur zyrtarisht Republikën e Kosovës.

Kjo antarësim përbën një hap të madh drejt fuqizimit të rolit sindikal të Policisë së Kosovës në skenën ndërkombëtare, duke kontribuar ndjeshëm në garantimin e të drejtave social-ekonomike dhe ligjore për pjesëtarët e saj. Po ashtu, përforcon zërin e Sindikatës në mbrojtjen e interesave të punonjësve të sektorit të sigurisë në nivel evropian.

Ky sukses është rezultat i angazhimit dhe përkushtimit të pandërprerë për të avancuar pozitën e punonjësve të policisë dhe për të ndërtuar ura bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare të ngjashme.



Forcimi i Bashkëpunimit Rajonal – Takimi i Parë Zyrtar me Unionin e Sindikatave të Pavarura të Policisë së Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës

Gjatë vitit 2024, një nga sukseset më të theksuara të Sindikatës së Policisë së Kosovës ishte realizimi i takimit të parë zyrtar bilateral me Unionin e Sindikatave të Pavarura të Policisë së Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, i cili u mbajt në qytetin e Sarajevës.

Ky takim shënon një moment të rëndësishëm në historikun e bashkëpunimit rajonal, duke krijuar një urë të re komunikimi dhe partneriteti ndërmjet dy organizatave sindikale, me theks të veçantë në:

Avancimin e të drejtave dhe interesave të pjesëtarëve të policisë,

Shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira, dhe

Identifikimin e sfidave të përbashkëta në fushën sindikale dhe të sigurisë.

Në kuadër të këtij takimi u organizua edhe një seminar tematik profesional me fokus në:

“Zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave të Sekrete në Organet e Punëve të Brendshme”.

Ky seminar shërbeu si platformë për ndarjen e njohurive, praktikave konkrete dhe përforcimin e bashkëpunimit institucional në çështje me rëndësi të ndjeshme dhe specifike për sektorin policor.

Ky aktivitet përforcon qasjen strategjike të Sindikatës së Policisë së Kosovës për:

Zgjerimin e bashkëpunimit me sindikatat homologe në rajon dhe më gjerë,

Përfaqësimin e denjë të anëtarëve të saj në arenën ndërkombëtare, dhe

Ngritjen e kapaciteteve sindikale për mbrojtjen e të drejtave ligjore dhe sociale të pjesëtarëve të policisë.

Ky takim u vlerësua si një arritje e rëndësishme për vitin 2024, duke hapur rrugë për projekte të përbashkëta në të ardhmen dhe konsolidimin e rolit të Sindikatës së Policisë së Kosovës në bashkëpunimet ndërkombëtare sindikale.



Pjesëmarrja në Konferencën Ndërkombëtare të CESP – 2024

Tema: “The New Security Landscape: Future of Policing”

Kryesia e Sindikatës së Policisë së Kosovës mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të organizuar nga Këshilli Evropian i Sindikatave Policore (CESP), ku përfaqësuesit e saj prezantuan sfidat dhe kërkesat aktuale të zyrtarëve policorë të Kosovës.

Fokusi kryesor i prezantimit:

Krijimi i kontratës kolektive sektoriale për garantimin e kushteve të qëndrueshme të punës.

Rishikimi i moshës së pensionimit, duke reflektuar natyrën e veçantë dhe të rrezikshme të punës policore.

Përforcimi i mbrojtjes shëndetësore dhe sociale për zyrtarët dhe familjet e tyre.

Pjesëmarrja në këtë forum evropian siguroi:

Ngritjen e zërit të zyrtarëve policorë të Kosovës në një platformë ndërkombëtare me ndikim.

Ndërtimin e aleancave me sindikata homologe evropiane për mbështetje dhe bashkëpunim në çështje të përbashkëta.

Shkëmbim përvojash dhe praktikash të mira me përfaqësues të vendeve anëtare të CESP.

Kjo pjesëmarrje konfirmon rolin aktiv dhe përfaqësues të Sindikatës së Policisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare, si dhe angazhimin e saj për avancimin e të drejtave të pjesëtarëve të saj përmes dialogut, profesionalizmit dhe përkushtimit sindikal.



Takimi bilateral me Sindikatën e Policisë së Maqedonisë së Veriut

Në kuadër të aktiviteteve ndërkombëtare, përfaqësuesit e Sindikatës së Policisë së Kosovës realizuan një takim zyrtar me drejtuesit e Sindikatës së Policisë së Maqedonisë së Veriut. Takimi

kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave sindikale dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy organizatave. Palët u dakorduan për hartimin e një agjende të përbashkët veprimi, me fokus në përmirësimin e kushteve të punës dhe të drejtave të punonjësve të policisë. Takimi u zhvillua në një atmosferë bashkëpunuese dhe kontribuoi në forcimin e lidhjeve sindikale rajonale.



Urim dhe mesazh për 25-Vjetorin e Policisë së Kosovës nga Kryetari i Këshillit Evropian të Sindikatave të Policisë (CESP), z. Ricardo Valadas

Sindikata e Policisë së Kosovës ka pranuar këtë mesazh urimi nga Këshilli Evropian të Sindikatave të Policisë (CESP) për përvjetorin e 25-të të Policisë së Kosovës. ‘Në emër të CESP, urime për këtë përvjetor të rëndësishëm! Jemi krenarë për shërbimin dhe mbrojtjen që oficerët e policisë ofrojnë për qytetarët, duke luftuar krimin e organizuar dhe terrorizmin, si dhe duke mbrojtur parimet demokratike. Si anëtarë të sindikatës, ata gjithashtu luftojnë për të drejtat e tyre në punë. CESP është krenare që ka Sindikatën e Policisë së Kosovës si Vëzhgues në familjen evropiane të policisë. Ne ofrojmë mbështetje të plotë për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat tuaja. Roli i CESP është kyç për bashkimin dhe fuqizimin e sindikatave policore në Evropë’.

Pjesëmarrja në Lojërat e 22-ta të Sindikatës së Policisë së Maqedonisë dhe Forcimi i Bashkëpunimit Rajonal

Kryesia e Sindikatës së Policisë së Kosovës, me ftesë të Sindikatës së Policisë së Maqedonisë, ka realizuar një vizitë zyrtare me rastin e Lojërave të 22-ta të Sindikatës së Policisë së Maqedonisë. Gjatë kësaj vizite, përfaqësuesit e Sindikatës së Policisë së Kosovës patën mundësinë të marrin pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme sportive dhe të krijojnë ura të reja bashkëpunimi mes dy sindikatave.

Përveç kësaj, gjatë vizitës, kryesia u takua edhe me përfaqësues të sindikatave të shteteve evropiane. Këto takime ishin një mundësi e shkëlqyer për të shkëmbyer përvoja, për të diskutuar sfidat e përbashkëta dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet sindikatave të rajonit.

Kjo vizitë shërbeu si një platformë e rëndësishme për të promovuar vlerat e solidaritetit, bashkëpunimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë. Të gjitha sindikatat u angazhuan për të vazhduar dhe thelluar bashkëpunimin në të ardhmen, në dobi të anëtarëve të tyre dhe të komunitetit të gjerë policor.



Pjesëmarrja në ngjarjen përkujtimore dhe sportive në Kroaci dhe shkëmbimi i përvojave me sindikatat rajonale

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, nga data 30 maj deri më 2 qershor 2024, delegacioni i Sindikatës së Policisë së Kosovës mori pjesë në aktivitetin sportiv të organizuar në Rovinj, Kroaci, me ftesë të Kryetarit të Sindikatës së Policisë së Kroacisë, z. Zdravko Loncar.

Ngjarja u zhvillua në nderim të zyrtarëve policorë të rënë në detyrë dhe shërbeu si platformë për shkëmbim përvojash dhe forcim të bashkëpunimit me sindikatat e vendeve të rajonit.



Pjesëmarrja e Sindikatës së Policisë së Kosovës në takimet rajonale dhe evropiane në Maqedoninë e Veriut

Nga data 07 deri më 10 shtator 2023, delegacioni i Sindikatës së Policisë së Kosovës, me ftesë të Kryetarit të Sindikatës së Policisë së Maqedonisë së Veriut, z. Marijan Kicev, mori pjesë në vizitë zyrtare në Ohër dhe Strugë.

Në këtë aktivitet morën pjesë edhe delegacione sindikale nga rajoni dhe Kryesia e Këshillit të Sindikatave të Evropës, e kryesuar nga z. Ricardo Valadas.

Takimet shërbyen për shkëmbim përvojash dhe forcim të bashkëpunimit për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe zhvillimin e iniciativave të përbashkëta ndër-sindikale.

Pjesëmarrja e Sindikatës së Policisë së Kosovës në themelimin e Shoqatës Ballkanike të Sindikatave të Sektorit të Sigurisë (B.A.T.U.P.S.O)

Më 09.05.2023, në Sofje të Bullgarisë, u mbajt kuvendi themelues i Shoqatës Ballkanike të Sindikatave të Sektorit të Sigurisë (B.A.T.U.P.S.O), me pjesëmarrjen e sindikatave të përfaqësuara nga Shqipëria, Bullgaria, Kosova, Rumania, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

Shoqata synon të mbështesë përmirësimin e interesave socio-ekonomike të anëtarëve, forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe organizimin e veprimeve të përbashkëta për të drejtat e punëtorëve. Sindikata e Policisë së Kosovës është një nga anëtarët themelues të kësaj shoqate, me të drejta të barabarta në vendimmarrje dhe përfaqësim.



Pjesëmarrja e Kryesisë Ekzekutive të Sindikatës së Policisë së Kosovës në punëtorinë e Koalicionit për Drejtësi Shoqërore dhe të Drejta Socio-Ekonomike

Nga data 02.12.2022 deri më 04.12.2022, Kryesia Ekzekutive e Sindikatës së Policisë së Kosovës mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Koalicioni për Drejtësi Shoqërore dhe të Drejta Socio-Ekonomike në Tiranë, me temën "Dialogu shoqëror për drejtësi shoqërore".

Punëtorja dy ditore trajtoi çështje të rëndësishme si të drejtat në punë, shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës, lejën prindërore, dhe avancimin e agjendës së punës së denjë në Kosovë. Diskutimet e frytshme midis organizatave partnere, sindikatave dhe përfaqësuesve nga Ministria e Financave, Punës dhe Transferit çuan në zhvillimin e një kornize logjike dhe plani veprimi për promovimin e dialogut shoqëror dhe avancimin e të drejtave të punës.

Kjo punëtori u organizua në kuadër të projektit "Dialogu shoqëror për drejtësi shoqërore" dhe mbështetet nga Olof Palme International Center dhe Qeveria Suedeze.

Pjesëmarrja e Sindikatës së Policisë së Kosovës në 30-vjetorin e Sindikatës së Policisë së Maqedonisë së Veriut

Me ftesë të kryetarit z. Marjan Kicev, delegacioni i Sindikatës së Policisë së Kosovës mori pjesë në manifestimin e 30-vjetorit të Sindikatës së Policisë së Maqedonisë së Veriut, nga 26 deri më 30 maj 2022.

Në këtë ngjarje morën pjesë edhe sindikata nga rajoni dhe Evropa, përfshirë edhe Kryetarin e CESP, z. Ricardo Valadas. Delegacioni ynë zhvilloi takime pune me përfaqësues të CESP, ku u prezantua organizimi sindikal në Kosovë, sfidat dhe planet për të ardhmen.

U kërkua përkrahje për anëtarësimin e Sindikatës së Policisë së Kosovës në CESP, dhe u mor premtimi se do të llobojnë dhe përkrahin këtë iniciativë.



MARRVESHJET VENDORE

Në kuadër të aktiviteteve sindikale, Sindikata e Policisë së Kosovës, gjatë këtij mandati, ka realizuar një varg marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme, me qëllim të përmirësimit të kushteve të anëtarëve të saj dhe familjeve të tyre.

Këto marrëveshje përfshijnë bashkëpunime me spitale private, klinika shëndetësore, laboratorë të analizave, qendra rehabilituese, institucione të arsimit të lartë (fakultete), banka komerciale, si dhe kompani të derivateve dhe produkteve të konsumit të përditshëm.

Përmes këtyre marrëveshjeve, pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë përfituar lehtësira të ndryshme si zbritje në çmime, qasje më të shpejtë në shërbime, përparësi në trajtime mjekësore, si dhe mundësi tjera që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien dhe jetën e përditshme të tyre.

Këto rezultate janë arritur falë angazhimit dhe përkushtimit të Strukturës Qendrore të Sindikatës së Policisë së Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me kryetarët e njësive rajonale sindikale në të gjitha rajonet e Policisë së Kosovës. Ky bashkëveprim ka qenë thelbësor për arritjen e këtyre marrëveshjeve dhe përfaqëson një shembull të mirëfilltë të funksionimit të organizuar dhe të bashkërenduar sindikal në shërbim të anëtarësisë.







Në vijim, do të gjeni listën e bizneseve që kanë ofruar zbritje për sindikalistët e Policisë së Kosovës:



Sindikata e Policisë së Kosovës

Lista e bizneseve që kanë ofruar zbritje për sindikalistet e PK-së

Kompania	Veprimtaria	Zbritja%
Spitali - FATI IM	Shërbime të kontrollit dhe ekzaminimeve mjekësore dhe intervenimeve operative	30%
KOLEGJI REZONANCA	Shkollimi dhe në shërbimet mjekësore në Kolegjin Alma Mater Europaea Campus College 'Rezonanca' si dhe në shërbime mjekësore	10-20%
AVICENA KS	Shërbime për analiza mjekësore laboratorike	50%
HOSPITAL – PEJË	Ofrimi i shërbimeve mjekësore për anëtarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës – DRP Pejë dhe Policisë Kufitare DRP Perëndimi me zbritje deri në 25%	25%
BIOLAB ZAFI	Ofrimi i shërbimeve laboratorike me zbritje deri në 20% sipas marrëveshjes për pjesëtarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës dhe pjesëtarëve të familjes së ngushtë.	20%
QDT Medina	Ofrimi i shërbimeve të caktuara shëndetësore të mjekësisë familjare dhe mjekësisë specialistike si dhe analizave laboratorike nga ana e QDT 'Medina' për pjesëtarët e Policisë së Kosovës anëtarë të SPK-së	40%
PROED	Shkolla për Programim PROED-it, si dhe trajnimet e ndryshme profesionale dhe punë praktike nga fusha e TIK-ut.	20-25%
SMILE	Ofrimi i shërbimeve stomatologjike	20%

BIOANALIZA	Ofrimi i shërbimeve nga Poliklinika Bioanaliza për pjesëtarët e Policisë së Kosovës duke u mundësuar zbritje të shërbimeve në: Mjekësi familjare, mjekësi interne, pulmologji, kardiologji, endokrinologji, gastroenterologji etj.	30%
DENTAL ZONE SHPK	Ordinancë Stomatologjike 'Dental Zone SHPK' për pjesëtarëve të PK-së zbritje prej 30% në të gjitha shërbimet stomatologjike	30%
DENTLINE	Ordinancës Specialistike Stomatologjike DENTLINE, ka për qëllim që t'u mundësoj të gjithë pjesëtarët e PK-së zbritje prej 30% në të gjitha shërbimet stomatologjike.	30%
ELAB-KOSOVA	Shërbime laboratorike, kontrollet pediatrie dhe pulmologjije me zbritje 20%.	20%
QTA STORE SHPK	Kjo marrëveshje ka për qëllim që t'u mundësoj të gjithë anëtarëve të Sindikatës së Policisë së Kosovës - Shoqata Sindikale - Regjioni i Mitrovicës zbritje te arka 3% të mallit të blerë në kategorinë (ushqim, higjienë, tekstil dhe teknikë).	3%
QDT MEDINA	Ofrimi i shërbimeve të caktuara shëndetësore të mjekësisë familjare dhe mjekësisë specialistike si dhe analizave laboratorike nga ana e QDT 'Medina' për pjesëtarët e Policisë së Kosovës anëtarë të SPK-së	40%
VICIANA MED	Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë "VICIANA MED" me zbritje deri ne 10% nga cmimi total i vitit shkollor.	10%
ETIKA	Shërbime laboratorike / analizat me 30% zbritje	30%
KOLEGJIT 'BIZNESI'	Për zbritjen e tarifave për studime. Nga çmimi real 1000€ për një vit akademik, pjesëtarët e Policisë dhe familjarëve të tyre u mundësohet të paguajnë 800€ për një vit akademik.	20%
CAMBRIDGE CLINICAL LABORATORIES	Marrëveshje bashkëpunimi mes Sindikatës së PK-së dhe 'Cambridge Clinical Laboratories'	Sipas kontrates
OLIVE MEDICAL GROUP	Shërbimet që kryhen analizat laboratorike si: Biokimi, Mikrobiologji dhe Patologji. Te gjitha këto analiza laboratorike janë me 20% zbritje sipas marrëveshjes.	20%
EMONA CENTER SH. P. K	Shërbimet që ofrohen për blerësit që furnizohen më pakicë në të gjitha marketet 'Emona Center' me zbritje deri ne 0.03%	3%
DOA PHARMACY CENTER	'Doa Pharmacy Center Sh. P. K për shitjen e esenciale të produkteve medicinale dhe farmaceutike me pakicë, me zbritje deri 10%.	10%
Rexhep Halimi B. I	Rexhep Halimi B. I të Regjionit të Mitrovicës. Marrëveshja përcakton që çmimi i furnizimit për pranuesin e barnave të jetë me zbritje 10% nga çmimi i shitjes.	10%
ONIX SPA LLC	Nënshkruhet marrëveshja mes Sindikatës së Policisë së Kosovës dhe Spitalit Special për Terapi Fizikale me Rehabilitim Onix SPA LLC në Banjë - Istog	30%

AGAJ – MEDICAL	Ordinanca Mjekësore 'AGAJ – MEDICAL' ofron shërbime si: Vizita mjekësore, vizita mjekësore shtëpiake, vizita mjekësore specialistike kardiologjike, internistike, onkologjike dhe specialisti i mjekësisë familjare.	30%
BANJA E KLLOKOTIT	Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm "BANJA E KLLOKOTIT" SH.P.K. Kllokot	30%
NËNA NAILE	Qendra për Mjekësi Fizikale dhe Rehabilitim banja "Nëna Naile" në Kllokot	30%
PROGRAMI AEC	Programit AEC' për gjuhë angleze	50%
LABORATORIT "BIOHIT SHPK"	Laboratorit "BIOHIT SHPK"	20%
POLIKLINIKA "FATI"	Poliklinika Fati	15%
ARJETA GROUP	Arjeta Group	3%
PINEA MEDICAL CENTER	Laborator	20%
OPTIKA MODA SH.P.K	Optikë	50%
EUROPEAN CLINIC	Spitali Special për Gjinekologji dhe Obstetrikë	20-50%
OLIVE MEDICAL GROUP	Laborator	20%
EX FIS - SHPK	Furnizim me derivate	0.6 CENT PËR LITËR
HIB PETROL	Furnizim me derivate	0.7 CENT PËR LITËR
KASTRATI	Furnizim me derivate	0.8 CENT PËR LITËR

APR SH.P.K.

Asistencë e përgjithshme rrugore për shërbime të asistencës rrugore në Kosovë dhe Evropë për Policinë e Kosovës me zbritje në paket: Pako APR Evropë 17% dhe Pako APR Plus 25% zbritje

17-25%

ProCredit Bank

Sindikata e Policisë së Kosovës, ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me ProCredit Bank, përmes së cilës Banka ofron oferta speciale për shërbime bankare për të gjithë stafin e punësuar në Policinë e Kosovës.

Poliklinika Pleura

Të gjithë anëtarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës dhe familjarët e tyre të ngushtë përfitojnë 30% zbritje në shërbimet: pulmologji, radiologji, ortopedi, gastroenterologji, laborator dhe shërbimet e kujdesit primarë shëndetësor

30%

Synergy Clinic

Të gjithë anëtarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës përfitojnë 25% zbritje në shërbimet që ofron kjo odinancë (terapi fizikale, terapi e kombinuar, terapi me radiofrekuencë, dry needling therapy, kiropraktike dhe osteopati).

25%

ASHA

Sindikata e Policisë së Kosovës dhe ASHA nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi për ofrimin e shërbimeve të printimit me cilësi të lartë dhe kosto të përballueshme. Marrëveshja u nënshkrua nga nënkryetari i Sindikatës,

25%

ASHA

Sindikata e Policisë së Kosovës dhe ASHA nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi për ofrimin e shërbimeve të printimit me cilësi të lartë dhe kosto të përballueshme. Marrëveshja u nënshkrua nga nënkryetari i Sindikatës,

25%

**Granit Fejza
Physiotherapy**

Granit Fejza Physiotherapy" dhe Shoqatës Sindikale të Policisë së Kosovës, Rajoni i Mitrovicës. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është ofrimi i shërbimeve të specializuara fizioterapeutike për anëtarët e Shoqatës Sindikale, familjarët e tyre të ngushtë, duke përfshirë bashkëshortët/et dhe fëmijët.

50%

**Laboratorin
Medical Klinik**

Shoqata Sindikale e Policisë së Kosovës për Rajonin e Ferizajt ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Laboratorin Medical Klinik në Ferizaj. Bazuar në këtë marrëveshje, Medical Klinik do të ofrojë zbritje deri në 30% për shërbimet e saj për të gjithë pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

30%

AKTIVITETET SINDIKALE

Sindikata e Policisë së Kosovës ka vazhduar aktivitetet e saj në stacione dhe drejtoritë policore, duke zhvilluar takime të rëndësishme dhe duke përmirësuar kushtet e punës për punonjësit e Policisë. Këto vizita dhe takime janë pjesë e angazhimeve të sindikatës për të avancuar të drejtat e punonjësve dhe për të forcuar solidaritetin mes anëtarëve të saj. Takimet, të cilat përfshijnë përfaqësues të lartë të sindikatës dhe drejtorë të ndryshëm të Policisë, si dhe anëtarët e njësive sindikale, kanë pasur një fokus të veçantë në përmirësimin e kushteve të punës, sigurimin shëndetësor dhe jetësor për punonjësit, si dhe në zhvillimin e ligjeve të reja që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre. Puna e sindikatës ka sjellë mbështetje të fuqishme nga menaxhmenti dhe autoritetet, duke treguar angazhimin e përbashkët për një mjedis pune më të drejtë dhe më të sigurt.



Më 8 tetor 2024, kryesia ekzekutive e Sindikatës së Policisë së Kosovës, e përbërë nga nënkryetarët Avdi Hoti dhe Edita Azemi, kryetari i BSPK-së prof. Atdhe Hykolli, koordinatori Kapiten Shemsi Igrishta dhe kryetari i Shoqatës Rajonale Mitrovicë, Rreshter Avni Tahiri, zhvilluan një takim me drejtoreshën e Drejtorisë Rajonale Mitrovicë Jug, Kolonel Afërdita Mikullovc. Në këtë takim u diskutua për aktivitetet sindikale, arritjet dhe planifikimet e ardhshme. Një çështje kyçe ishte nevoja për një ligj mbi pensionimin dhe sigurimin shëndetësor, i cili është thelbësor për përmirësimin e kushteve të punës për policët. Diskutimi ishte frytdhënës dhe u përqendrua në forcimin e solidaritetit midis anëtarëve. Kolonel Mikullovc ofroi mbështetje të fuqishme për qëllimet e sindikatës, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë midis sindikatës dhe menaxhmentit. Kjo mbështetje është një hap i rëndësishëm për avancimin e të drejtave të policëve dhe për krijimin e një mjedisi pune më të drejtë dhe më të sigurt.



Më 19 shtator 2024, kryesia ekzekutive, e përbërë nga nënkryetari Avdi Hoti, nënkryetarja Edita Azemi, dhe kryetari i shoqatës rajonale DRP Prizren Kapiten Shaqir Uka, zhvilluan një takim pune të suksesshëm me drejtorin rajonal të Prizrenit, Kolonel Faton Alija.

Gjatë këtij takimi u diskutuan në detaje aktivitetet sindikale, të arriturat e deritanishme, dhe planifikimet për të ardhmen. Diskutimi ishte frytdhënës dhe u përqendrua në përmirësimin e kushteve të punës dhe forcimin e solidaritetit midis anëtarëve. Kolonel Alija ofroi mbështetje të fuqishme për qëllimet tona, duke dëshmuar rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë midis sindikatës dhe menaxhmentit.

Kjo mbështetje është një hap i madh përpara në misionin tonë për të avancuar të drejtat e policëve dhe për të forcuar zërin tonë. Bashkë, mund t'i arrijmë këto qëllime dhe të krijojmë një mjedis pune më të drejtë dhe më të sigurt për të gjithë. Ftojme të gjithë kolegët t'i bashkohen kësaj përpjekjeje të përbashkët për një të ardhme më të mirë.



17.09.2024, kryesia ekzekutive, nënkryetari Avdi Hoti, nënkryetarja Edita Azemi, dhe kryetari i shoqatës sindikale të kufirit, Azem Berisha, me kërkesë të kryetarit të njësisë sindikale të aeroportit, Fadil Sopi, mbajtën takim pune me anëtarësinë e gjerë sindikale - zyrtarët policorë të aeroportit të Prishtinës “Adem Jashari”.

Nënkryetari Avdi Hoti i njoftoi antarësinë e gjerë lidhur me punën e kryesisë ekzekutive të sindikatës për të arriturat në përgjithësi dhe për punën që po bën kryesia ekzekutive drejt realizimit të kërkesave të punonjësve të Policisë së Kosovës.

Në përfundim të takimit, kryetari i njësisë sindikale, Fadil Sopi, së bashku me anëtarësinë sindikale të aeroportit, falënderuan kryesinë ekzekutive për informacionet e marra lidhur me të gjitha çështjet e diskutuara dhe për punën që po vazhdojnë drejt realizimit të të gjitha të drejtave ligjore. Kryesia ekzekutive mori mbështetje të fuqishme nga kryetari Fadil Sopi dhe anëtarësia sindikale e aeroportit.

Kryetari i Sindikatës së Policisë së Kosovës, i shoqëruar nga nënkryetari, vizituan Pikën Kufitare në Merdare, ku u pritën nga Komandanti i kësaj pike dhe kolegët e tij. Gjatë takimit, u diskutua për kushtet e punës, gjendjen aktuale të mirëqenies ekonomiko-sociale të të punësuarve dhe angazhimet e tjera policore. Kryetari i Sindikatës falënderoi të gjithë pjesëtarët e Policisë së Kosovës për përkushtimin e tyre në kryerjen e detyrave zyrtare dhe ruajtjen e sigurisë së vendit.

Më 23 nëntor 2023, Kryetari dhe Nënkryetari i Sindikatës së Policisë zhvilluan një takim pune me Kryetarin, Nënkryetarin dhe Sekretarin e Sindikatës së Re të NPK Trafiku Urban SH.A. Në këtë takim u diskutua për bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimeve sindikale me qëllim përmirësimin e kushteve të punës dhe mirëqenies së anëtarëve të të dyja sindikatave. Kryesia e Sindikatës së Policisë falënderoi Sindikatën e Re të Trafikut Urban për vizitën dhe gatishmërinë për bashkëpunim.

Në datën 23 nëntor 2023, u zhvillua një tryezë e rrumbullakët rajonale në Pejë, e organizuar nga OJQ 'HUMAN', në kuadër të projektit “Fuqizimi i lidhjeve në mes të Shoqërisë Civile dhe Institucioneve Publike për promovimin e sundimit të ligjit në Kosovë”. Temë e diskutimit ishte “Sigurimi shëndetësor dhe jetësor për pjesëtarët e Policisë së Kosovës”. Në këtë tryezë morën pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore, aktivistë sindikalë dhe përfaqësues të OJQ-ve. Diskutimi u fokusua në gjetjen e mundësive dhe mënyrave për sigurimin shëndetësor dhe jetësor për të gjithë pjesëtarët e Policisë së Kosovës. Si konkluzion, u theksua rëndësia e bashkëpunimit me OJQ-të për realizimin e këtij qëllimi, duke organizuar projekte dhe aktivitete të ndryshme. Gjithashtu, u propozuar organizimi i një tryeze diskutimi të nivelit rajonal ndërkombëtar, duke përfshirë të gjitha institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, me temën “Sigurimi shëndetësor dhe jetësor për pjesëtarët e Policisë së Kosovës”. Ky propozim u përkrah nga të pranishmit dhe OJQ “HUMAN” dhe OJQ “AGIMI ISNIQ” premtuan mbështetje sipas mundësive të tyre.



Në takimet e zhvilluara në Stacionet Policore të Lipjanit dhe Graçanicës, dy nënkryetarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës, Avdi Hoti dhe Edita Azemi, u takuan me kryetarët e Njësisë Sindikale të këtyre dy qyteteve. Ata diskutuan për aktivitetet aktuale të sindikatës, sfidat me të cilat përballen punonjësit e Policisë së Kosovës, si dhe për Ligjin e pagave dhe ligjet e tjera të rëndësishme për ta. Gjithashtu, u prezantuan marrëveshjet e realizuara me spitale, laboratorë,

qendra për mjekësi fizikale dhe rehabilitim, universitete dhe barnatore. Nënkryetari Hoti inkurajoi pjesëmarrësit që të bëhen anëtarë të sindikatës për të forcuar pozitat dhe për të mbështetur kërkesat legjitime të policëve. Anëtarësimi mund të bëhet përmes platformës E-Kosova.



VIZITAT NË ZYRET E SINDIKATËS

Në ambientet e zyrës së Sindikatës së Policisë së Kosovës, Ambasadori për Paqe, z. Tahir Shabani, zhvilloi një vizitë zyrtare, ku u prit nga kryesia ekzekutive e sindikatës. Gjatë këtij takimi, u diskutuan mundësitë për krijimin e urave të bashkëpunimit përmes Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim (ICD), me qëllim forcimin e lidhjeve me sindikatat ndërkombëtare, përfshirë ato në Francë dhe Zvicër. Po ashtu, u theksua rëndësia e trajnimeve të ndryshme për zhvillimin e Policisë së Kosovës. Ambasadori Shabani shprehu gatishmërinë për të ndihmuar në krijimin e bashkëpunimeve të reja, duke theksuar rëndësinë e përkrahjes ndërkombëtare në zhvillimin e Policisë së Kosovës përmes trajnimeve të ndryshme që do të realizohen në të ardhmen për policinë dhe Sindikatën e PK-së. Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt avancimit të rolit të Sindikatës së Policisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare.



Më 25.06.2024 kryesia ekzekutive e Sindikatës së Policisë së Kosovës Nënkryetari z.Avdi Hoti dhe Nënkryetarja e dytë znj.Edita Azemi pritën në takim kryetarin e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës z.Atdhe Hykolli.

Në takim u diskutuan çështjet me rëndësi për anëtarësinë dhe bashkëpunimin ndërmjet Federatës së Sindikatës së Policisë së Kosovës dhe Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës. Po ashtu u diskutua lidhur me kërkesat e Sindikatës së Policisë së Kosovës drejtuar Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Qeverisë së R.Kosovës, ku nga kryetari z.Hykolli u përkrahën kërkesat dhe përpjekjet e Sindikatës së Policisë së Kosovës në drejtim të përmbushjes së këtyre kërkesave. Si çështje tjetër u diskutua edhe kontrata kolektive e përgjithshme në nivel vendi dhe po ashtu edhe kontrata kolektive sektoriale për Policinë e Kosovës.

Kryesia ekzekutive e falënderoi kryetarin z.Hykolli për përkushtimin dhe mbështetjen e dhënë Sindikatës së Policisë së Kosovës në të gjitha proceset po ashtu edhe në procesin e fundit në të cilin kaloi Sindikata e Policisë së Kosovës.



Me 27 shkurt 2023, në ambientet e zyrës të Sindikatës së Policisë së Kosovës, Nënkryetarja e dytë e Sindikatës së Policisë së Kosovës, znj. Edita Azemi dhe Kryetarja e Shoqatës Sindikale për DRP

Prishtina znj. Ajfer Xhigolli realizuan një takim zyrtar me përfaqësuesit e KFOR-it italian në Kosovë.

Gjatë këtij takimi u diskutua për punën dhe veprimtarinë e Sindikatës së Policisë së Kosovës, për projektet dhe kërkesat që janë të parapara në mandatin e Sindikatës së PK-së, po ashtu me interesim të veçantë është diskutuar për Ligjin e Pagave rreth pakënaqësive dhe pritshmërisë nga ky ligj si dhe për Stafin Civil dhe mbështetës kategorizimi i tyre në këtë ligj.

Gjatë bisedës, znj. Azemi falënderoi përfaqësuesit e KFOR-it italian për mbështetjen dhe përkrahjen që po afrojnë për Policinë e Kosovës në lidhjen e urave të bashkëpunimit mes Sindikatës së PK-së dhe KFOR-it italian me seli në Prishtinë për të mirën e të dy institucioneve si KFOR-i dhe Policia e Kosovës.



Me 27 qershor 2022, në ambientet e zyrës të Sindikatës së Policisë së Kosovës, Nënkryetari z. Avdi Hoti dhe Nënkryetarja e dytë e Sindikatës së Policisë së Kosovës, znj. Edita Azemi realizuan një takim zyrtar me përfaqësuesit e KFOR-it britanik në Kosovë.

Gjatë këtij takimi u diskutua për punën dhe veprimtarinë e Sindikatës së Policisë së Kosovës, ku nënkryetari i Sindikatës së PK-së, i njoftoj përfaqësuesit e KFOR-it britanik për projektet dhe kërkesat që janë të parapara në mandatin e Sindikatës së PK-së të cilat duhet të realizohen për përmirësimin e mirëqenies së pjesëtarëve të Policisë së Kosovës. Gjithashtu nënkryetari z. Hoti, informoj se Sindikata e PK-së, pas marrjes së mandatit të ri, ka realizuar shume marrëveshje dhe bashkëpunime, gjithashtu njoftoj se në kuadër të projekteve, është lansuar edhe webfaqja e re e Sindikatës (www.spk-rk.eu) si dhe krijimi i rrjetit social të Sindikatës në Facebook, ku çdo aktivitet, marrëveshje, informacione postohen dhe informohen zyrtaret policor për aktivitetet sindikale për përmirësimin e mirëqenies së pjesëtarëve të Policisë së Kosovës.

Gjatë bisedës, z. Hoti falënderoj përfaqësuesit e KFOR-it britanik për mbështetjen e vazhdueshme dhe përkrahjen që po afrojnë për Policinë e Kosovës në lidhjen e urave të bashkëpunimit mes Sindikatës së PK-së dhe KFOR-it britanik me seli në Prishtinë për të mirën e të dy institucioneve si KFOR-i dhe Policia e Kosovës.

Përfaqësuesit e KFOR-it britanik, u shprehen të gatshëm për bashkëpunim, në veçanti për PK-në e cila është bartësja kryesore e sigurisë në Kosovë.



Kryesia Ekzekutive e Sinikatës së Policisë së Kosovës, u takuan me ekipin e ekspertëve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Gjatë këtij takimi, Kryesia ekzekutive e SPK-së ju kanë dëshiruar mirëseardhje ekipit të ekspertëve dhe i kanë njoftuar rreth punës përgatitore që kryesia e re e Sindikatës së PK-së është duke vepruar në përmbushjen e obligimeve të parapara me statut të Sindikatës së PK-së.

Gjatë takimit, u diskutua mbi sfidat e punonjësve të Policisë së Kosovës, ku është diskutuar edhe për tri çështjet më kryesore si 'Ligji për paga', 'Ligji për sigurimin shëndetësor' dhe 'Ligji për pensionim të parakohshëm'.

Sindikata e Policisë së Kosovës falënderon ekipin dhe ambasadën Amerikane për përkrahjen e vazhdueshme ndaj Policisë së Kosovës dhe punonjësve të saj.



Kryetari dhe përfaqësuesit e Sindikatës së Policisë së Maqedonisë së Veriut, vizituan Sindikatën e Policisë së Kosovës

Me 29.12.2021, Kryesia Ekzekutive e Sinikatës së Policisë së Kosovës, priten në takim zyrtar përfaqësuesit e Sindikatës së Policisë së Maqedonisë së Veriut të kryesuar nga kryetari z. Dr. Marjan Kicev, nënkryetari z. Dugagjin Kashtanjeva, z. Borge Grujevski anëtarë i kryesisë Qendrore, z. Hismet Sinani dhe z. Lulzim Vranovci zyrtar të kabinetit të zyrës së Ministrit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjatë këtij takim, Kryesia Ekzekutive e Sinikatës së Policisë së Kosovës ju kanë dëshiruar mirëseardhje përfaqësueseve të Sindikatës së Policisë së Maqedonisë së Veriut dhe i kanë njoftuar ata rreth punës përgatitore që kryesia e re e Sindikatës së PK-së është duke vepruar në përmbushjet dhe obligimet që janë të parapara me statut të Sindikatës së PK-së.

Gjatë takimit, u diskutua mbi sfidat e punëtorëve, ku është diskutuar edhe për tri çështjet më kryesore si ‘Ligji për paga’, ‘Ligji për sigurimin shëndetësor’ dhe ‘Ligji për pensionim të parakohshëm’.

Gjithashtu në këtë takim është folur rreth bashkëpunimit mes Sindikatës së PK-së dhe Sindikatës së Policisë së Maqedonisë së Veriut në shumë fusha duke marrë parasysh së Sindikata e Policisë së Maqedonisë së Veriut i ka të rregulluar mirë këto ligje.

Ndërsa nga ana e tyre, kryetari z. Dr. Marjan Kicev tha, më lejoni që përzemërsisht t’ju uroj për zgjedhjen tuaj si kryetar i ri i Sindikatës se PK-së dhe t’ju uroj shumë suksese në ushtrimin e detyrave tuaja të reja në Sindikatën e PK-së. Gjithashtu theksoj se dëshiroj t’a shfrytëzoj këtë rast që të shpreh dëshirën dhe bindjen time të plotë që marrëdhëniet miqësore mes dy sindikatave ndërmjet

Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës do të vazhdojnë të fuqizohen për të mirën e dy policive dhe u shprehen të gatshëm për një bashkëpunim të vazhdueshëm mes dy sindikatave të Policisë.

Delegacioni i kryesuar nga Kryetari me bashkëpunëtor, ka bërë homazhe tek pllaka përkujtimore për 21 zyrtarët policorë të rënë në detyrë.

LOJRAT SPORTIVE NE KUADER TE AKTIVITETEVE SINDIKALE

Në kuadër të aktiviteteve sindikale, Sindikata e Policisë së Kosovës ka organizuar çdo vit turneun tradicional sportiv në nderim të zyrtarëve policorë të rënë në krye të detyrës. Ky aktivitet është një shprehje e përkushtimit për të nderuar kolegët e ndjerë dhe për të promovuar vlerat e bashkëpunimit, solidaritetit dhe shëndetit fizik ndërmjet anëtarëve të sindikatës.

Turneu sportiv është bërë një ngjarje e rëndësishme në kalendarin e Sindikatës, duke tërhequr pjesëmarrjen e gjerë të drejtuesve të lartë institucionalë dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë. Në keto aktivite kanë marrë pjesë Drejtori i Policisë së Kosovës, ministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfaqësues nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, përfaqësues të KFOR-it, Ushtrisë së Kosovës, kryetarë dhe përfaqësues të sindikatave rajonale, si dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Evropian të Sindikatave të Policisë (CESP).

Keto turne sportiv jo vetëm që nderojnë kujtimin e zyrtarëve të rënë, por gjithashtu forcojnë lidhjet ndërmjet anëtarëve të sindikatës dhe institucioneve të tjera, duke kontribuar në ndërtimin e një mjedisi pune më të bashkuar dhe më të shëndetshëm.

Këto aktivitete janë një dëshmi e përkushtimit të Sindikatës së Policisë së Kosovës për të mbështetur anëtarët e saj dhe për të promovuar një kulturë të respektit dhe bashkëpunimit brenda forcës policore.

Përmes aktiviteteve sportive, Sindikata e Policisë së Kosovës nderon zyrtarët policorë të rënë në krye të detyrës

Prizren, 25 Tetor 2024, Qendrën Sportive "Sezai Surroi" në Prizren, u mbajt ceremonia e hapjes së Lojërave Tradicionale, një aktivitet i përvitshëm i organizuar për të nderuar zyrtarët policorë të rënë në krye të detyrës. Në këtë ngjarje të veçantë, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore, përfaqësues të sindikatave dhe miq të Kosovës u bashkuan për të kujtuar sakrificën dhe guximin e këtyre heronjve.

Nënkryetarja e Sindikatës së Policisë së Kosovës, znj. Edita Azemi, në fjalën e saj theksoi rolin e pazëvendësueshëm të sindikatës në mbështetjen e zyrtarëve policorë dhe promovimin e të drejtave të tyre. Ajo nënvizoi se Lojërat Tradicionale nuk janë thjesht një aktivitet sportiv, por një mundësi për të kujtuar dhe nderuar guximin e zyrtarëve që nuk janë më fizikisht në mesin tonë, duke ndërtuar një lidhje të fortë mes të gjallëve dhe heronjve të rënë. Ajo falënderoi z. Jesus Lira Calvo, Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit Evropian të Sindikatave të Policisë (CESP), për pjesëmarrjen

dhe mbështetjen e tij, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për të forcuar sindikalizmin policor dhe për të siguruar mirëqenien e punonjësve të policisë.

Znj. Azemi theksoi se prania e përfaqësuesve nga rajoni është një dëshmi e angazhimit të përbashkët për të ndarë praktikat më të mira dhe për të avancuar çështjet e të drejtave dhe kushteve të punës për zyrtarët policorë. Në veçanti, pjesëmarrja e përfaqësuesve nga Bullgaria dhe Qipro u mirëprit si një hap i rëndësishëm drejt zgjerimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar. "Lavdi dhe nderim të përjetshëm për zyrtarët tanë policorë të rënë në krye të detyrës!"

Ndërsa zv. Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, z. Bardhyl Dobra, vlerësoi guximin dhe përkushtimin e zyrtarëve policorë që dhanë jetën për sigurinë e vendit. Ai në emër të ministrit Sveçla theksoi se detyra e mbrojtjes së qytetarëve dhe ruajtjes së integritetit shtetëror është një mision fisnik dhe i shenjtë që duhet të nderohet vazhdimisht.

Ndërsa në fjalën e tij, nënkolonel Faton Alia, Drejtori Rajonal i Drejtorisë Policore në Prizren, në emër të Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së, shprehu mirënjohje të thellë për të gjithë ata që kanë sakrifikuar jetën e tyre për një të ardhme të sigurt dhe për rolin e rëndësishëm që luan Policia e Kosovës në këtë drejtim. Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit mes institucioneve dhe komunitetit për të nderuar dhe kujtuar sakrificat e policisë, duke ndërtuar kështu një frymë uniteti dhe solidariteti që i lidh të gjithë qytetarët.

I pranishëm në këtë ngjarje të rëndësishme ishte edhe nënkryetari i Komunës së Prizrenit, z. Kujtim Gashi, i cili ishte nikoqir i eventit.

Në këtë event të rëndësishëm pjesë e të cilit ishte z. Jesus Lira Calvo, Sekretari i Përgjithshëm i CESP, prania e tij ishte tregues i qartë i mbështetjes së CESP për përpjekjet e sindikatës sonë dhe angazhimin e tij për përmirësimin e kushteve dhe të drejtave të punonjësve të policisë në nivel rajonal dhe evropian.

Fjalimi i tij përqendrohej në rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në fuqizimin e zërit të sindikalizmit policor për t'u përballur me sfidat e përbashkëta që ballafaqohen në të gjithë Evropën.

Nënkryetari i parë i Sindikatës së PK-së, z. Avdi Hoti, i shoqëruar nga zv. ministri i Punëve të Brendshme z.Dobra, zv. drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës z.Jankoviç, nënkryetari i Komunës së Prizrenit dhe nënkryetarja e Sindikatës, në shenjë falënderimi i nderoi me mirënjohje përfaqësuesit miq të sindikatave rajonale që ishin të pranishëm në këtë manifestim si, Sindikatën e Policisë së Shtetit Shqiptar, Sindikatën e Policisë së Maqedonisë së Veriut, Sindikatën e Policisë së Malit të Zi, Sindikatën e Policisë së Qipros, Sindikatën e Policisë së Bullgarisë, Sindikatën e Policisë së Kroacisë, si dhe përfaqësuesit e CESP-it dhe organizatorët e kësaj ngjarjeje sportive, për përkushtimin dhe mbështetjen e tyre në realizimin e këtij eventi të rëndësishëm.

Në përfundim të ceremonisë, u falënderuan të gjithë sponsorët që kanë mbështetur dhe kontribuar për realizimin e këtij eventi sportiv të rëndësishëm. Pa përkrahjen e tyre, organizimi dhe zhvillimi i kësaj ngjarjeje sportive nuk do të ishte i mundur. Mbështetja e tyre dëshmon rëndësinë dhe solidaritetin në nderimin e zyrtarëve policorë të rënë në krye të detyrës dhe përforcon vlerat e bashkëpunimit dhe unitetit në komunitet.

Në përmbyllje të kësaj ceremonie, Sindikata e Policisë së Kosovës uroi të gjitha ekipet sportive pjesëmarrëse për suksese dhe lojëra të mbarë. Me shpresën se ky aktivitet do të frymëzojë jo vetëm për të nderuar kujtimin e heronjve tanë, por edhe për të forcuar vlerat e miqësisë, bashkëpunimit dhe solidaritetit mes të gjithë pjesëmarrësve, le të mbizotërojë fryma sportive dhe respekti i ndërsjellë në çdo garë.

Lojën e parë sportive zyrtarisht e filluan Nenkryetari i sindikatës z.Hoti së bashku me djalin e Heroit Bunjaku.

Lavdi dhe nderim të përjetshëm për zyrtarët tanë policorë të rënë në krye të detyrës.









Ngritet flamuri i Sindikatës në majet e larta të Greqisë

Aktivisti i njohur sindikal nga rajoni i Pejës, njëherësh zyrtari policor, Naser Zeqiraj, e përfaqësoj Sindikatën e Policisë së Kosovës, me bashkë-alpinistë të ndryshëm, ku gjatë këtij aktiviteti, aplinisti ngrit flamurin e Sindikates në majën Mytikas (Olimpit) 2918m ne shtetin grek.



Sindikata e Policisë së Kosovës organizoi Lojërat e shahut me datë 01.07.2024 në Akademinë Policore në Vushtri me iniciativën e Shoqatës Sindikale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës dhe dy instruktorëve të Akademisë policore.

Turniri u mbajt në shenjë të shënimit të vitit jubilar të gjeneratës së 60-të. Në turnir morën pjesë rreth 40 kandidat të përkrahur nga Major Rrahim Fazliu edhe nga Federata e Shahut të Republikës së Kosovës ku pas përfundimit të lojërave janë ndarë kupat dhe mirënjohjet për vendin e parë, të dytë dhe të tretë.



Sindikata e Policisë së Kosovës nderon 23 heronjtë e PK-së

Më 27 tetor 2023, përmes organizimit të lojërave sportive të mbajtura në Gjakovë, Sindikata e Policisë së Kosovës nderoi dhe përkujtojë 23 heronjtë e Kosovës, të cilët kanë rënë në kryerje të detyrës zyrtare.

Në këtë event sportiv të organizuar nga Sindikata e Policisë së Kosovës morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës Kolonel Gazmend Hoxha, Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, Kryesia Ekzekutive e Sinikatës së Policisë së Kosovës, përfaqësues nga sindikatat e vendeve mike si Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kroacia, familjarë të policëve të rënë në kryerje të detyrës, përfaqësues të FSK-se, KFOR-it, si dhe menaxhmenti policorë nga niveli qendror dhe ai lokal.

Sindikata e PK-së si ç'do herë vazhdon t'i përkrah dhe mbështet zyrtarët policorë në aspektin sindikal, e po ashtu duke mos i harruar kurrë edhe familjarët e policëve të rënë në kryerje të detyrës, ku bijtë e tyre dhanë atë me sublimen, dhanë jetën e tyre në shërbim të vendit dhe qytetarëve të Kosovës.

Ky event sportiv i organizuar nga Sindikata e PK-së u përkrah dhe u mbështet me donacione nga donator të ndryshëm të cilëve në shenjë falënderimi iu janë ndarë mirënjohje.



Aktivisti i njohur sindikal nga rajoni i Pejës, njëherësh zyrtari policor, Naser Zeqiraj, me bashkë-alpinistë të ndryshëm organizuan një shëtitje në bjeshkët e bukura të Shqipërisë, ku i cili u ngjit në majën më të lartë të bjeshkëve të Valbonës.



Sindikata e Policisë së Kosovës nderon 22 heronjtë e PK-së të cilët kanë rënë në kryerje të detyrës zyrtare

Më 04 nëntor 2022 në Pejë, Sindikata e Policisë së Kosovës hapi turneun tradicional të lojërave sportive i cili organizohet në shenjë nderimi dhe përkujtimi të zyrtarëve policorë të rënë në kryerje të detyrës.

Në këtë event sportiv të organizuar nga Sindikata e Policisë së Kosovës morën pjesë përfaqësues nga sindikatat e vendeve mike nga rajoni dhe më gjerë, përfaqësues nga Komuna e Pejës, familjarë të policëve të rënë në kryerje të detyrës dhe menaxhmenti policorë nga niveli qendror dhe ai lokal. Sindikata e PK-së në shenjë falenderimi ndau mirënjohje për përfaqësuesit e Sindikatave nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kroacia dhe përfaqësuesit nga Kuvendi Komunal i Pejës. Po ashtu, Sindikata e PK-së ndau një mirënjohje të veçantë për Këshillin Evropian të Sindikatave Policore (CESP) të cilët përmes zëvendës sekretarit të tyre, kishin adresuar një letër falënderimi për sindikatën e PK-së.

Gjatë këtij event sportiv, Sindikatës së Policisë së Kosovës, nga zëvendës sekretari i përgjithshëm i Këshillit Evropian të Sindikatave Policore (CESP), z. Marian Kicev, iu kumtua lajmi pozitiv se Sindikatës së PK-së u është pranuar kandidatura në anëtarësim të CESP- së.

Në rastin e pranimit të kandidaturës, Kryetarit të Sindikatës, z. Zeqirit iu dhurua edhe një shenjë me mbishkrimin CESP.

Sindikata e PK-së pas anëtarësimit të plotë pritet të jetë anëtare me të drejta të barabarta krahas të gjitha sindikatave të policive evropiane.

Sindikata e PK-së vazhdon t'i përkrah dhe mbështet zyrtarët policorë në aspektin sindikal, përfshirë dhe duke mos i harruar kurr edhe familjarët e policëve të renë në kryerje të detyrës, ku bijtë e tyre dhanë atë me sublimen, dhanë jetën e tyre në shërbim të vendit dhe qytetarëve të Kosovës.

Ky event sportiv i organizuar nga Sindikata e PK-së u përkrah dhe u mbështet me donacione nga Komuna e Pejës dhe kompani të ndryshme, të cilëve Sindikata e PK-së u është shumë mirënjohëse dhe falënderuese.



AKTIVITETET E SHOQATAVE SINDIKALE

Në kuadër të aktiviteteve të saj të vazhdueshme, Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK), me përkushtim të madh punon për mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave të anëtarëve të saj. Duke ndjekur misionin sindikal dhe angazhimin në promovimin e mirëqenies së zyrtarëve policorë, SPK ka organizuar dhe mbështetur aktivitete të shumta në nivel qendror dhe rajonal.

Këto aktivitete kanë për qëllim jo vetëm forcimin e lidhjeve ndërmjet anëtarëve sindikalë, por edhe ngritjen e vetëdijes për të drejtat e tyre, nxitjen e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe promovimin e vlerave sindikale. Në vazhdim, paraqesim disa nga aktivitetet e realizuara, të cilat dëshmojnë përkushtimin e Sindikatës në organizimin e ngjarjeve të karakterit social, informues, edukues dhe bashkëpunues, në përputhje me frymën e organizimit sindikal në nivel vendi.

Këto aktivitete pasqyrojnë angazhimin e Sindikatës së Policisë së Kosovës në avancimin e të drejtave të zyrtarëve policorë dhe në krijimin e një ambienti profesional, të drejtë dhe përfshirës për të gjithë anëtarët e saj.

Shoqata Rajonale e DPP-së dhe DRP-së, në mbështetje të Kryesisë së Sindikatës së PK-së me rastin e 8 Marsit, ka organizuar një ekskursion për anëtarët e saj të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë. Ky aktivitet është një iniciativë për të forcuar lidhjet mes anëtarëve të sindikatës, duke ofruar mundësinë për të njohur më mirë funksionimin dhe aktivitetet e këtyre institucioneve. Këto ekskursione kanë për qëllim që të rrisin bashkëpunimin dhe kuptimin mes punonjësve të policisë, të inkurajojnë një komunikim më të hapur dhe të ndihmojnë në zhvillimin e një mjedisi më të përmirësuar të punës brenda institucioneve të sigurisë. Pra, ky aktivitet u realizua në Shqipëri, duke ofruar një mundësi të shkëlqyer për të ndarë përvoja dhe praktika të mira mes kolegëve.





Sindikata e Policisë së Kosovës -Njësia Sindikale e Aeroportit - Kufirit, gjatë fundjavës kanë zhvilluar një ekskursion shetitje – aktivitet sindikal në shtetin e Shqipërisë.



Sindikata e Policisë së Kosovës -Shoqata e Sindikatës Rajonale të Policisë- DRP Gjilan, gjatë fundjavës kanë zhvilluar një ekskursion shetitje – aktivitetet sindikal në shtetin e Shqipërisë.



Shoqata e Sindikatës Rajonale të Policisë DRP Mitrovicë e përfaqësuar nga kryetari i shoqatës Rr.Avni Tahiri së bashku me anëtarët sindikal të DRP Mitrovicë gjatë fundjavës kanë zhvilluar një ekskursion shetitje – aktivitetet sindikal në shtetin e Shqipërisë.



Më datë 10 dhe 11 Qershor 2022 në kampin dy-ditor për barazi gjinore i organizuar nga Koalicioni për drejtësi shoqërore dhe të drejta socio-ekonomike në bashkëpunim me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) dhe në kuadër të projektit “Dialog Social për Drejtësi Sociale” ku kanë marr pjesë përfaqësues të sindikatave të ndryshme të Kosovës që janë pjesë e BSPK-së ndër to edhe përfaqësues nga Sindikata e Policisë së Kosovës.

Është diskutuar rreth përfaqësimit gjinor dhe politikave që promovojnë barazinë gjinore nëpër sindikatat përkatëse si dhe janë marr rekomandime nga gratë sindikaliste të cilat më pas do të adresohen në planifikimet e aktiviteteve të ardhshme.

Ky aktivitet është realizuar nga PEN, në kuadër të Projektit “Dialogu social për barazi sociale”.



DONACIONET NË MBËSHTETJE TË ANËTARËVE DHE PAISJEVE TË POLICISË SË KOSOVËS


Në kuadër të angazhimeve të saj të vazhdueshme për përmirësimin e kushteve të punës dhe mirëqenies së anëtarëve, Sindikata e Policisë së Kosovës ka pranuar donacione të ndryshme nga donatorë vendorë dhe ndërkombëtarë. Këto donacione përfshijnë pajisje teknike dhe materiale që kontribuojnë në rritjen e efikasitetit dhe sigurisë në punën e përditshme të policisë. Gjithashtu, janë ofruar ndihma dhe mbështetje direkte për anëtarët sindikalë, duke përfshirë pajisje dhe asistencë në raste të veçanta. Këto kontribute janë dëshmi e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet sindikatës dhe partnerëve të saj, me qëllim për të forcuar kapacitetet operationale dhe për të siguruar një mjedis pune më të sigurt dhe më të mirë për të gjithë zyrtarët policorë.

Në vijim, gjeni detajet e raportit të plotë mbi donacionet e pranuar dhe shpërndarjen e tyre.

Sindikata e Policisë së Kosovës ka pranuar një donacion prej 10 shtëpizash të avancuara kompjuterike nga donatori nga mërgata, z. Zejadin Dedinca.

Me dëshirën e donatorit, ky donacion është dedikuar për Stacionin Policor Obiliq, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe fuqizimin e kapaciteteve teknologjike për punonjësit e policisë.

Sindikata e Policisë së Kosovës shpreh mirënjohje dhe falenderim për këtë donacion.



Policia e Kosovës, për nder të festave të fundvitit 2024, organizoi një aktivitet festiv, ku morën pjesë edhe përfaqësues të Sindikatës së Policisë së Kosovës. Gjatë këtij organizimi u grumbullua një fond për SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, bazuar në vetëkontributin me mjete financiare. Në këtë iniciativë, Sindikata e Policisë së Kosovës kontribuoi në fond me mjete të siguruar nga kuotat sindikale.

Nënkryetari i Sindikatës vlerësoi kontributin dhe solidaritetin e treguar nga pjesëmarrësit, të cilët mblodhën 3,235 euro për SOS Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës. Ky donacion simbolizon zemërgjerësinë dhe përkushtimin e Sindikatës së Policisë së Kosovës dhe zyrtarëve policorë për të ndihmuar ata që kanë më shumë nevojë.

Sindikata e Policisë së Kosovës, me kënaqësi, kontribuoi një pjesë të këtyre mjeteve, duke shpresuar se, sado pak, ky kontribut do të ndihmojë SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë.



Sindikata e Policisë së Kosovës njofton për zhvillimin e një takimi frytdhënës me përfaqësuesit e kompanisë “Golden Eagle.” Gjatë këtij takimi, u shprehën falënderime për mbështetjen e vazhdueshme dhe bashkëpunimin e çmuar që kjo kompani ka treguar ndaj zyrtarëve policorë. Me këtë rast, theksojmë kontributin e veçantë të “Golden Eagle” edhe këtë vit, ku gjatë natës së ndërrimit të moteve, do të ofrojë pije freskuese për zyrtarët policorë në detyrë. Ky akt përfaqëson një shembull solidariteti dhe respekti ndaj punës së palodhshme të zyrtarëve të rendit. Sindikata e Policisë së Kosovës falënderon “Golden Eagle” për bashkëpunimin dhe përkrahjen e tyre të vazhdueshme.



Më datë 17.12.2024, sikurse çdo vit tjetër, kemi pranuar 136 dhurata nga kompania EXFIS, dedikuar fëmijëve të zyrtarëve policorë të Stacionit Policor Lipjan dhe dy nënstacioneve, Janjevë dhe Magurë.

Dhuratat janë pranuar nga Kryetarja e Njësisë Sindikale të Stacionit Policor Lipjan, znj. Luljeta Statovci, në kuadër të DRP Prishtinë.

Faleminderit kompanisë EXFIS për këtë gjest të bukur që sjell gëzim për fëmijët në prag të festave të fundvitit!



Përrurimi i stacionit të ri policor në Mamushë – një hap i rëndësishëm për sigurinë dhe kushtet e punës

Sindikata e Policisë së Kosovës, e përfaqësuar nga Nënkrjetari z. Avdi Hoti dhe Nënkrjetarja znj. Edita Azemi, shprehin kënaqësinë dhe mbështetjen për përrurimin e Stacionit të ri policor në Mamushë. Ky investim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përrurimit të kushteve të punës për zyrtarët policorë dhe garantimit të sigurisë për qytetarët e kësaj komune.

Në ceremoninë e përrurimit ishin të pranishëm Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Kolonel Gazmend Hoxha, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, Krjetari i Komunës së Mamushës, z. Abdulhadi Krasniq, Komandanti i Stacionit të ri policor, Toger Enis Orqusha, si dhe përfaqësues të shumtë të Policisë së Kosovës dhe komunitetit lokal.

Stacioni i ri policor është ndërtuar me standardet më të larta moderne, duke krijuar një mjedis pune të denjë dhe funksional për zyrtarët policorë. Ky projekt shpreh përkushtimin e përbashkët të institucioneve dhe Sindikatës për të forcuar infrastrukturën policore, me qëllim të ofrimit të shërbimeve më cilësore për qytetarët dhe përrurimit të mirëqenies së zyrtarëve policorë.

Sindikata e Policisë së Kosovës mbetet e përkushtuar për të promovuar dhe mbrojtur interesat e zyrtarëve policorë, duke punuar pandërprerë për përrurimin e kushteve të punës dhe krijimin e mjediseve që nxisin efikasitet dhe profesionalizëm. Ky përrurim është një dëshmi e qartë e përpjekjeve tona të përbashkëta për një polici më të fortë dhe një siguri më të madhe për qytetarët e Kosovës.

Sindikata e Policisë së Kosovës – Zëri i Policëve, për një Kosovë më të Sigurt!



Sindikata e Policisë së Kosovës - Shoqata Rajonale e Sindikatës DRP Gjakovë ka pranuar një donacion DRON # CMIIT nga një donator nga mërgata.

Donacioni në fjalë ju është ndarë për shfrytëzim Stacionit Policor Malishevë nga kryetari i shoqatës rajonale sindikale Bekim Dervishaj.



Shoqata Sindikale DRP Ferizaj, DRP Mitrovicë dhe Njësia Sindikale e Stacionit Policor Lipjan kanë pranuar dhurata për fund vit

Nga Kompania Golden Eagle janë dhuruar pako me pije për stacionet e DRP Ferizaj ndërsa Kompania EXFIS ka dhuruar dhurata për fëmijët e pjesëtarëve të Njesisë Speciale dhe dhurata për fëmijët e pjesëtarëve të Stacionit Policor në Lipjan.

Falenderojmë Kompanitë Golden Eagle dhe EXFIS duke ju uruar sukses dhe mbarësi në Vitin e Ri 2024.

Me date 17.10.2023 ishim për vizitë te familja e heroit Afrim Bunjaku së bashku me përfaqësuesit e DRP Pejë dhe përfaqësuesit e fondacionit Plavë-Guci me seli në Amerikë, ku ju dhurua një donacion familjes së rreshterit Afrim Bunjaku në vlerë prej 9200 dollar.



Me iniciativën e Ndërmarrjes EURO FOOD me seli në Prizren, Sindikata e Policisë së Kosovës ka pranuar një donacion me gjëra ushqimore, për policët e angazhuar në Planin Operativ në veri të vendit. Në këtë donacion janë dhuruar gjëra ushqimore dhe pije. Me autorizim verbal nga Kryesia Qendrore e Sindikatës, donacionin e ka pranuar Kryetari i Shoqatës Sindikale për DRP Mitrovicën e Jugut z. Avni Tahiri.



MBËSHTETJE E PALODHUR PËR ZYRTARËT POLICORË TË LËNDUAR NË KRYE TË DETYRËS

Sindikata e Policisë së Kosovës ka demonstruar një angazhim të palëkundur për mirëqenien e anëtarëve të saj, veçanërisht për ata që janë lënduar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare. Në çdo rast të lëndimit, Sindikata ka qëndruar pranë tyre, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme dhe duke u angazhuar maksimalisht për stabilizimin e gjendjes së tyre shëndetësore. Vizitat e shpeshta në spitale, sigurimi i ndihmës ligjore dhe mbështetje psikologjike janë disa nga veprimet konkrete që Sindikata ka ndërmarrë për të siguruar që zyrtarët policorë të lënduar të ndihen të mbrojtur dhe të vlerësuar. Ky angazhim i pandërprerë është një dëshmi e përkushtimit të Sindikatës për të mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e anëtarëve të saj në çdo situatë.

Sindikata e Policisë së Kosovës shpreh solidaritetin e saj të plotë për zyrtarët policorë të lënduar në vetaksidentin e fundit të trafikut. Sot, nënkryetari i Sindikatës, z. Avdi Hoti, së bashku me z. Besim Krasniqi, Kryetar i Shtabit të Përgjithshëm në DPP, vizituan policët e lënduar, duke shprehur kujdesin dhe përkushtimin e Sindikatës për shëndetin dhe mirëqenien e tyre.

Në këtë rast, Sindikata u uron të lënduarve shërim të shpejtë dhe i inkurajon ata që të vazhdojnë me forcë dhe guxim në mbrojtje të ligjit, sigurisë dhe rendit kushtetues dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës.

Ngjarje e fundit dhe ngjarje të tilla theksojnë domosdoshmërinë e sigurimit të plotë shëndetësor për policin e Kosovës që çdo ditë përballen me rreziqe të shumta. Sindikata i bën thirrje edhe një

herë institucioneve shtetërore të trajtojnë me prioritet sigurimin shëndetësor për të gjithë pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

Përkushtimi ndaj mirëqenies së policëve nuk është vetëm një detyrim ndaj tyre, por një hap i rëndësishëm drejt rritjes së sigurisë dhe efikasitetit në shërbim të qytetarëve.



SOLIDARITET DHE MBËSHTETJE PËR POLICËT E LËNDUAR

Sindikata e Policisë së Kosovës u uron shërim të shpejtë zyrtarëve policorë të lënduar në aksidentin e fundit të trafikut. Duke shprehur shqetësimin për këtë ngjarje, Sindikata bën thirrje urgjente drejtuar të gjithë akterëve shtetërorë për të siguruar mbulimin shëndetësor për punonjësit e Policisë së Kosovës.

Sindikata i drejtohet Qeverisë së Kosovës me kërkesën që të ndërmerren masa të menjëhershme për sigurimin e mbështetjes shëndetësore për policët. Kjo kërkesë vjen si pasojë e një vetaksidenti të fundit, ku një automjet policor pësoi aksident, duke lënë të lënduar tetë zyrtarë policorë. Ngjarje të tilla, që po përsëriten shpesh, theksojnë mungesën e një mbulimi të duhur shëndetësor për ata që çdo ditë përballen me rreziqe të larta në shërbim të vendit.

Sindikata thekson se sigurimi i mbështetjes së plotë shëndetësore për policët është urgjente dhe e domosdoshme, jo vetëm për mirëqenien e tyre, por edhe për garantimin e efikasitetit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Çështja e sigurimit shëndetësor për policët është ngritur prej kohësh, por deri më tani, institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur të ofrojnë një zgjidhje konkrete. Sindikata e Policisë së Kosovës mbetet e përkushtuar që të vazhdojë të angazhohet për të drejtat dhe mirëqenien e punonjësve të saj, duke kërkuar nga institucionet e Republikës së Kosovës që t'i japin kësaj çështjeje prioritetin që meriton.

Me datë 06.03.2024 Këshilli Drejtues i Sindikatës së Policisë ka mbajtur mbledhje dhe ka shqyrtuar listat e propozuara nga Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore dhe nga Shoqatat Sindikal për zyrtarët policorë të cilët janë plagosur dhe lënduar në veri të Kosovës dhe për ata që janë duke u trajtuar me sëmundje të rënda.

Lidhur me këtë çështje Këshilli Drejtues, me shumicë të votave, ka marr vendim që nga listat e përpiluara të ndahen për secilin nga pesëqind (500) euro, për të gjithë ata që janë anëtarë të sindikatës, kurse ata që nuk janë anëtar të kontaktohen dhe t'ju mundësohet pranimi i kësaj ndihme në momentin që e bëjnë deklarinim e anëtarësimit në sindikatë.

Mjetet financiare do të ndahen nga donacioni i dhuruar nga fondi humanitar GOLDEN EAGLE dhe nga fondi i anëtarësisë së SPK-së.

Për fondin humanitar të dhuruar nga fondacioni GOLDEN EAGLE, Sindikata e Policisë së Kosovës falënderon publikisht donatorin.

Kryesia Ekzekutive e Sindikatës së Policisë së Kosovës, kanë vizituar familjarët e policit të vrarë Afrim Bunjaku, të cilëve u kanë shprehur ngushëllimet më të sinqerta duke u solidarizuar me dhimbjen e tyre.

Po ashtu gjatë ditës kanë vizituar policin e plagosur Alban Rashitin i cili gjendet i shtrirë në QKUK, duke i dëshiruar shërim të shpejtë dhe kthim në familjen e vet!



SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS: ANGAZHIMI I PALODHSHËM PËR MBROJTJEN E DINJITETIT DHE SIGURISË SË ANËTARËVE TË SAJ

Në kuadër të angazhimeve të vazhdueshme për përmirësimin e kushteve të punës dhe jetesës së zyrtarëve policorë, Sindikata e Policisë së Kosovës ka ndërmarrë një sërë veprimesh të rëndësishme. Këto përfshijnë reagime ndaj vonesave në pagesat e ndërrimeve të natës dhe orëve shtesë, si dhe ndaj sulmeve ndaj zyrtarëve policorë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare. Sindikata ka shprehur shqetësimin e saj për këto çështje dhe ka kërkuar veprime të menjëhershme për adresimin e tyre.

Në vijim, paraqesim reagimet e Sindikatës të cilat pasqyrojnë angazhimin e saj të palodhur për mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të saj dhe për sigurimin e kushteve të nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre me dinjitet dhe siguri.

- **Reagim për Media**

Sindikata e Policisë së Kosovës shpreh shqetësimin e saj lidhur me vonesën në pagesën e ndërrimit të natës dhe orëve shtesë për zyrtarët policorë.

Në prag të festës, policët nuk e kanë marrë pagën e merituar, e cila është e domosdoshme për planifikimin e angazhimeve të tyre familjare dhe personale. Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre dhe ka krijuar pasiguri në lidhje me realizimin e angazhimeve të përditshme. Pavarësisht përkushtimit dhe sakrificës së vazhdueshme të zyrtarëve policorë, deri më tani nuk kemi marrë asnjë komunikim zyrtar nga Qeveria për këtë çështje.

Sindikata e Policisë e Kosovës kërkon nga Ministria e Financave që të ekzekutojë menjëherë pagesat e prapambetura, duke siguruar kompensimin e plotë për ndërrimet e natës dhe orët shtesë, në përputhje me të drejtat ligjore të zyrtarëve policorë. Kjo është e nevojshme për të ruajtur motivimin dhe angazhimin e tyre në shërbim të qytetarëve dhe sigurisë publike.

Sindikata e Policisë e Kosovës do të ndjekë këtë çështje nga afër dhe nuk do të hesht derisa të realizohet pagesa e plotë e të gjitha kompensimeve të papaguara. Ne do të vazhdojmë të mbrojmë të drejtat e zyrtarëve policorë dhe të kërkojmë zgjidhje të shpejta dhe të qëndrueshme për këtë çështje.

- **Reagim i Sindikatës së Policisë së Kosovës**

Sindikata e Policisë së Kosovës shpreh indignatën dhe shqetësimin e thellë për incidentin e rëndë ku një veturë me targa vendore ka tentuar ta godasë një zyrtar policor në detyrë. Zyrtari policor, për fat të mirë, ka arritur t'i shmangët goditjes nga kjo veturë, ndërkohë që i dyshuari, gjatë lëvizjes, ka shtënë me armë zjarri nga dritarja e automjetit.

Falë reagimit të shpejtë dhe profesional të Policisë së Kosovës, i dyshuari është arrestuar dhe aktualisht po përballlet me procedurat ligjore. Ky akt kriminal dhe i papranueshëm nuk përbën vetëm një sulm ndaj zyrtarit policor, por një sulm të drejtpërdrejtë ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës, rendit dhe sigurisë publike.

Sindikata i bën thirrje organeve të drejtësisë që të veprojnë me vendosmëri, duke siguruar që autori i këtij akti të përballlet me dënimin maksimal që parashikon ligji. Sulmet ndaj zyrtarëve policorë nuk duhet të tolerohen dhe duhet të trajtohen me prioritet për të dërguar një mesazh të qartë se ligji dhe rendi janë të pacenueshëm.

Zyrtarët policorë janë shtylla e sigurisë së qytetarëve dhe mbrojtjes së institucioneve të shtetit.

Policia e Kosovës është në shërbim të qytetarëve dhe Republikës së Kosovës, dhe çdo akt dhune ndaj saj duhet të dënohet fuqishëm nga të gjithë. Sindikata qëndron e palëkundur në përkrahje të çdo anëtari të Policisë së Kosovës dhe do të vazhdojë të kërkojë drejtësi dhe siguri maksimale për zyrtarët tanë.

- **Reagim nga Sindikata e Policisë së Kosovës**

Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK) nuk pajtohet me vlerën e propozuar nga qeveria për rritjen e pagave. SPK përshëndet çdo vendim të Qeverisë për rritjen e pagave në sektorin publik dhe mbështet idenë që kjo rritje të jetë lineare për të gjithë punonjësit. Megjithatë, SPK vlerëson se shumica e propozuar për këtë rritje nuk përkon me nevojat reale të punonjësve, duke pasur parasysh inflacionin dhe rritjen e çmimeve, si dhe nivelin e pagave të policisë në shtetet e rajonit tonë.

Duke u nisur nga këta faktorë, SPK kërkon që rritja e pagave për vitin 2025 të realizohet duke përfshirë një rritje totale prej dy koeficientësh. Konkretisht, sugjerohet që rritja e parë të zbatohet në janar për një koeficient dhe e dyta në qershor për një koeficient shtesë.

Kjo qasje do të sigurojë një mbështetje të qëndrueshme ekonomike për punonjësit tanë, duke përputhur pagat me rritjen e kostos së jetesës dhe me standardet e rajonit.

- **REAGIM, 15 TETOR 2024**

Prishtinë, Kosovë – Sindikata e Policisë së Kosovës dëshiron të shprehë shqetësimin e saj lidhur me rastet e fundit që po qarkullojnë në media dhe përhapjen e informacioneve të pasakta që synojnë të njollosin imazhin e Policisë së Kosovës dhe të anëtarëve të saj.

Policia e Kosovës është e përkushtuar për mbrojtjen e ligjit, rendit dhe territorit të Republikës së Kosovës, dhe veprimet saj janë gjithmonë në përputhje me standardet më të larta të profesionalizmit dhe etikës. Akuzat e pabaza dhe keq interpretimet në lidhje me veprimet e Policisë dëmtojnë rëndë imazhin e Policisë së Kosovës dhe minojnë besimin e qytetarëve në institucionet e rendit.

Sindikata e Policisë së Kosovës është e vendosur të ofrojë mbështetje juridike për të gjithë anëtarët e saj që janë prekur nga këto akuza të padrejta. Do të sigurojmë që të drejtat e çdo polici të mbrohen dhe që çdo sulm ndaj reputacionit të tyre të trajtohet me seriozitetin e duhur.

I bëjmë thirrje të gjitha mediave dhe individëve që të qasen me përgjegjësi ndaj informacionit dhe të sigurojnë që çdo raportim të jetë i saktë dhe i verifikuar. Të shprehësh mendime dhe kritika është e rëndësishme, por ato duhet të bazohen në fakte dhe prova të qëndrueshme.

Sindikata e Policisë së Kosovës do të vazhdojë të punojë në interes të anëtareve të saj, për të adresuar çdo shqetësim dhe për të promovuar një ambient të sigurt dhe të drejtë për të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës.

- **REAGIM ME DATË 24.06.2023**

Me datë 24.06.2023, një zyrtare policore, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, ka pësuar lëndime të rënda trupore të cilës i urojmë shërim të shpejtë. Ajo bashkë me kolegët e sajë, në Lagjen Veterniku në Prishtinë, kanë tentuar t'a ndalin një veturë, por shoferi i veturës qëllimisht e godet zyrtaren policore për t'i ikur kontrollit të policisë.

Lidhur me këtë rast, dënojmë ashpër këtë sulm ndaj Policisë së Kosovës, kurse nga organet e drejtësisë kërkojmë që të gjithë ata që sulmojnë Policinë, të dënohen sipas Ligjit me rrethana rënduese sepse sulmet ndaj policisë s'po kanë të ndalur!

Ky sulm dhe shumë të tjera që kanë ndodhur deri me tani, tregojnë se secili zyrtarë policorë e ka të rrezikuar shëndetin dhe jetën, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

- **KOMUNIKATË PËR MEDIA - PRISHTINË, 16 QERSHOR 2023**

Kryesia Ekzekutive e Sinikatës së Policisë së Kosovës, e cila ishte e shoqëruar nga Kolonel Hilmi Pacolli, z.Avni Tahiri dhe z.Eset Xhata kanë vizituar familjarët e policëve të Shemë Mustafës, Beqir Sefës dhe Rifat Zekës, tre policëve të Kosovës të rrëmbyer nga forcat serbe në kufi me Serbinë e në brendi të territorit të Republikës së Kosovës.

Kryesia Ekzekutive e Sinikatës së Policisë së Kosovës u mirëprit nga familjarët e Shemë Mustafës, Beqir Sefës dhe Rifat Zekës.

Kryetari i njoftoi familjarët se është duke monitoruar me kujdes çdo situatë dhe është në kontakt të vazhdueshëm me menaxhementin e PK-së, në përpjekje për të marrë sa më parë dhe sa më shumë informacione për gjendjen e policëve të rrëmbyer.

Kryetari i Sindikata së PK-së, kërkon urgjentisht që të lirohen zyrtarët policor, sepse është shkelje e çdo marrëveshje në kundërshtim të çdo parimi të normave ndërkombëtare sepse zyrtarët policor kanë qenë thellë brenda në territorin e Republikës së Kosovës, për të mbrojtur integritetin e vendit.

Ndërsa, familjarët e zyrtarëve policor u shprehën falënderues për vizitën dhe kujdesin e treguar nga Sindikata e PK-së.

- **KOMUNIKATË PËR MEDIA, PRISHTINË 14 QERSHOR 2023**

Sindikata e Policisë së Kosovës është e shqetësuar dhe dënon ashpër rastin e kidnapimit të tre zyrtarëve policorë të Kosovës, nga policia Serbe.

Zyrtarët policorë Rifat Zeka, Beqir Sefi dhe Mustafë Shema kanë qenë në Territorin e Republikës së Kosovës duke kryer detyrat e tyre sipas autorizimeve ligjore dhe Kushtetuese dhe nga një grup

i organizuar i pjesëtarëve të policisë Serbe pa paralajmërim kidnapohen dhe dërgohen në drejtim të panjohur deri me tani.

Përderisa rendi dhe ligji po zbatohet në vendin tonë, Sindikata e Policisë së Kosovës kërkon urgjentisht që të lirohen zyrtarët policor, sepse është shkelje e çdo marrëveshje në kundërshtim të çdo parimi të normave ndërkombëtare sepse zyrtarët policor kanë qenë thellë brenda në territorin e Republikës së Kosovës, për të mbrojtur integritetin e vendit.

Zyrtarëve policorë ju dëshirojmë që mos ju ndodh asgjë e keqe, kurse kërkojmë nga të gjithë mekanizmat vendor dhe ndërkombëtar që të njëjtit zyrtar policor të lirohen sa më parë dhe të kthehen në Policinë e Kosovës.

Policia e Kosovës janë krenaria e të gjithë neve prandaj ju jemi mirënjohës për punën, sakrificën, guximin dhe profesionalizmin që po e tregojnë për çdo ditë në përmbushjen e misionit të tyre.

Sindikata e Policisë së Kosovës

- **KOMUNIKATË PËR MEDIA - SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS DËNON ASHPËR SULMET NDAJ ZYRTARËVE POLICORË**

Me datë 26.05.2023, Policia e Kosovës, gjatë zbatimit të autorizimeve ligjore dhe kushtetuese, në veri të vendit janë sulmuar me mjete të ndryshme të rrezikshme nga grupe kriminale të organizuara me qëllim që kanë pësuar lëndime pesë zyrtarë policorë si dhe janë shkakuar dëme materiale në automjetet e tyre.

Sindikata e Policisë së Kosovës është e brengosur për shëndetin dhe jetën e zyrtarëve policorë të cilët pësuan lëndime e të cilëve ju dëshiron shërim të shpejtë.

Sindikata e Policisë së Kosovës është duke i përcjellur me vëmendje të gjitha zhvillimet e fundit duke qenë e brengosur për shëndetin dhe rrezikshmërinë e tyre që kanë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.

Prandaj, Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar në garantimin e rendit kushtetues, krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët, duke ju përmbajtur me dinjitet vizionit, misionit dhe vlerave të këtij profesioni fisnik. Përherë mirënjohës zyrtarëve policor.

Sindikata e Policisë së Kosovës

- **KOMUNIKATË PËR MEDIA**

Sindika e Policisë së Kosovës është duke i përciellur me vëmendje gjendjen aktuale në Kosovë, ku Policia e Kosovës vazhdon synimin e saj në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, ngritjen e partneritetit me qytetarët.

Policia e Kosovës ushtron autorizimet e tyre dhe kryejnë detyrat në mënyrë të ligjshme, të bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në ligjeve tjera në fuqi dhe në Kodin e Etikës, duke vepruar në mënyrë të paanshme për të mbrojtur jetën, pronën, sigurinë, kontrollin e kalimit kufitar për të gjithë pa dallim etnie apo nacionaliteti.

Me të njëjtin qëllim qëndrojnë zyrtarët policorë edhe në dy lokacionet e veriut të vendit, në Leposaviq dhe Jarinjë ku janë të bllokuar nga barikadat e vendosura nga grupe jolegjitime kriminale. Bllokimi i rrugëve ka hyrë në ditë në tetë dhe si pasojë është cenuar lëvizje e lirë e qytetarëve dhe organeve të rendit dhe zyrtarët policor në Leposaviq dhe Jarinjë kanë mbetur të bllokuar pa pasur mundësi t'ju bëhet ndrimi sipas rregullave për funksionim normal.

Sindikata e Policisë dhe të gjithë pjesëtarët e policisë janë duke i përcjellur nga afër këto zhvillime si dhe janë shumë të shqetësuar për fatin e kolegëve të bllokuar, prandaj u bëjmë thirrje urgjente Presidencës, Qeverisë, KFOR-it, EULEX-it dhe ambasadave të QUINT-it që të bashkërendojnë

veprimet dhe menjëherë të krijohen kushtet për lëvizje të lirë dhe zyrtarëve policor t'ju bëhet ndrrimi.

Zyrtarët policor në këto dy lokacione të bllokuara po qëndrojnë me moral shumë të lartë, por shëndeti dhe jeta e tyre është e rrezikuar seriozisht për shkak të kushteve të vështira të krijuara nga rrethanat dhe ambienti në të cilin qëndrojnë.

Duhet të kuptojmë se edhe durimi e ka fundin e vet edhe për ata që janë atje edhe për ne. Në këtë rast është tejkaluar gjithçka nga normalja sepse kemi të bëjmë me rrezikun e jetës nga sëmundje të ndryshme të zyrtarëve policorë dhe qytetarëve që banojnë në atë pjesë, tani më kemi të bëjmë me krizë humanitare, prandaj duhet të intervenohet urgjentisht!

ZOTIMET PËR MANDATIN E RI SINDIKAL

Në emër të Sindikatës së Policisë së Kosovës, po e hapim me përgjegjësi dhe përkushtim këtë kapitull të ri të përfaqësimit sindikal, duke e parë mandatin e ardhshëm si një mundësi të re për të fuqizuar zërin e çdo zyrtari policor në Policinë e Republikës së Kosovës. Në këtë rrugëtim, do të udhëhiqemi nga ndershmëria, transparenca dhe solidariteti. Përvoja e katër viteve të fundit na ka mësuar se ndryshimi kërkon angazhim të përditshëm, bashkëpunim të sinqertë dhe përfaqësim të paepur të interesave tona kolektive.

Prandaj, në vijim ju paraqesim misionin dhe vizionin, zotimet tona konkrete për mandatin e ardhshëm – zotime që synojnë jo vetëm përmirësimin e kushteve të punës, por edhe mbrojtjen e dinjitetit, shëndetit dhe të ardhmes sonë si pjesëtarë të një shërbimi jetik për sigurinë dhe rendin në Republikën e Kosovës.

MISIONI

Të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat, dinjitetin dhe mirëqenien e të gjithë pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, duke vepruar me përgjegjësi, profesionalizëm dhe integritet në përfaqësimin e interesave të tyre ligjore, sociale dhe ekonomike. Sindikata angazhohet për ndërtimin e një mjedisi të drejtë pune, ku çdo zyrtar policor të ndjehet i vlerësuar, i mbrojtur dhe i motivuar për të shërbyer me nder qytetarëve dhe shtetit të Kosovës.

VIZIONI

Të jemi një sindikatë e fuqishme, e qëndrueshme dhe e respektuar, që udhëheq me besueshmëri ndryshimet pozitive për Policinë e Kosovës, duke garantuar barazi, dinjitet profesional dhe përmirësim të vazhdueshëm të kushteve të punës dhe jetës për çdo zyrtar policor. Synojmë që përmes dialogut social, përfaqësimit të drejtë dhe bashkëpunimit ndër-institucional, të bëhemi

shembull i sindikalizmit bashkëkohor dhe mbështetës i fortë i shtetit të së drejtës.

Zotimet për mandatin e ri sindikal

1. Përmirësimi i kushteve të punës

- Do të angazhohemi fuqishëm për përmirësimin e infrastrukturës fizike në stacionet policore dhe ambientet e punës.
- Do të kërkojmë pajisje të reja, moderne dhe të standardizuara për të gjithë zyrtarët policorë.
- Do të insistojmë në respektimin e orarit të punës dhe pagesën e drejtë për orët shtesë, ndërrimet e natës dhe ditët e festave.

2. Negocimi i Kontratës Kolektive Sektoriale

- Do të kërkojmë rifillimin e bisedimeve për një kontratë kolektive të re sektoriale, e cila do të reflektojë pozitivisht me kushtet e punës në polici.
- Do të përfshijmë kërkesa të reja për përfitime shtesë për policët që kryejnë detyra në zonat me rrezikshmëri të lartë apo në kushte të veçanta.
- Do të sigurojmë mbrojtje më të madhe për të drejtat e pushimeve, lejeve të veçanta dhe përfitimeve familjare.
- Do të angazhohemi fuqishëm për të përfshirë pagën e 13-të për zyrtarët policorë si formë motivimi dhe vlerësimi për punën e tyre.
- Do të kërkojmë përfshirjen e sigurimit të udhëtimit për çdo zyrtar policor, në mënyrë që çdo detyrë jashtë vendit apo brenda, të zhvillohet me mbulim të plotë të shpenzimeve dhe rreziqeve.
- Do të insistojmë në përmirësimin e skemave të kompensimit në rast të lëndimeve në detyrë apo paaftësisë së përkohshme/përhershme për punë.

3. Siguria dhe Shëndeti në Punë

- Do të kërkojmë **implementimin e plotë të standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë** për të gjithë zyrtarët policorë.
- Do të llobojmë për trajnime të detyrueshme për menaxhimin e rrezikut dhe për parandalimin e dëmtimeve gjatë detyrës.
- Do të nxisim sigurimin e mbështetjes psikologjike dhe shërbimeve psikosociale për të gjithë zyrtarët që përballen me stres në krye të detyrës zyrtare.

4. Sigurimi Shëndetësor i Policëve

- Do të kërkojmë zbatim të **një skeme të veçantë sigurimi shëndetësor për Policinë**, që mbulon rreziqet dhe nevojat specifike të profesionit.
- Do të angazhohemi për sigurime shëndetësore shtesë për trajtime jashtë vendit dhe për lëndimet në detyrë.

- Do të punojmë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe MFPT për t'i përfshirë zyrtarët policorë në trajtime të privileguara mjekësore në kuadër të sistemit publik shëndetësor.

5. Ligji për Pensionimin e Policëve

- Do të angazhohemi për hartimin dhe miratimin e një Ligji të veçantë për Pensionimin te punonjesve te PK-se, pervojen e punes me stash te beneficuar që do të mundësojë pensionim të parakohshëm dhe dinjitoz.
- Do të kërkojmë që pensionet të jenë të lidhura me pagat e fundit dhe të përshtatura me inflacionin.
- Do të bashkëpunojmë me deputetët, qeverinë dhe partnerët ndërkombëtarë për të garantuar miratimin e këtij ligji.

Këto zotime përbëjnë **bazën e angazhimit tonë për mandatin e ri**, me synim për t'i kthyer policëve të Kosovës dinjitetin dhe sigurinë që meritojnë. Përkushtimi ynë do të jetë i plotë, me veprim të organizuar, profesional dhe me vendosmëri të palëkundur.

Ky mandat i ri nuk është vetëm një periudhë e re pune, por është një angazhim i ripërtërirë ndaj çdo zyrtari që i shërben këtij vendi me ndershmëri dhe përkushtim.

Nëpërmjet këtyre zotimeve, ne premtojmë të jemi zëri juaj i fuqishëm në tryezat e vendimmarrjes, për të siguruar që dinjiteti i policit të mos jetë vetëm një fjalë, por një realitet i përditshëm.

Bashkë do të ndërtojmë një sindikatë më të fortë, më të guximshme dhe më të aftë për të mbrojtur interesat e secilit prej jush.

Në këtë rrugëtim, do të fuqizojmë dhe zgjerojmë bashkëpunimin tonë me Këshillin Evropian të Sindikatave Policore (CESP), duke siguruar që zëri i Policisë së Kosovës të dëgjohet dhe të përfaqësohet në nivel ndërkombëtar, në përputhje me standardet më të avancuara evropiane për të drejtat e punëtorëve dhe sigurinë në shërbim.

Me respekt dhe përkushtim,

Z. Avdi HOTI,

Nënkryetari i Sindikatës së Policisë së Kosovës

RAPORTI 2022-2025



'Zëri që nuk është ndalur asnjëherë në mbrojtje të dinjitetit policor'



+383 38 50 80 1256



www.spk-rk.eu



Sindikata e Policisë së Kosovës